

**U D H Ë Z I M**  
**Nr.6, datë 10.2.2004**

**PËR MARRËVESHJET BILATERALE PËR SHMANGIEN E TAKSIMIT TË DYFISHTË  
DHE PARANDALIMIN E EVAZIONIT FISKAL**

Në mbështetje të nenit 102, pika 4 të Kushtetutës së Republikës të Shqipërisë dhe në zbatim të ligjit nr.8560, datë 22.12.1999 “Për procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë” (nenet 10 dhe 24), në zbatim të marrëveshjeve bilaterale të përfunduara nga Republika e Shqipërisë për shmangien e taksimit të dyfishtë dhe parandalimin e evazionit fiskal (lista e marrëveshjeve bashk[ngjitur] të cilat janë nënshkruar dhe kanë hyrë në fuqi në përputhje me dispozitat e ligjit nr.8371, datë 9.7.1998 “Për lidhjen e marrëveshjeve dhe traktateve ndërkombëtare”, Ministri i Financave

**UDHËZON :**

1. Baza ligjore për përfundimin e marrëveshjeve për eliminimin e taksimit të dyfishtë.

Në zbatim të ligjit nr.8560, datë 22.12.1999 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë” (neni 10), Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve ka negociuar një sërë marrëveshjesh ndërkombëtare për eliminimin e tatimeve të dyfishta (marrëveshje tatimore), të cilat janë nënshkruar dhe kanë hyrë në fuqi në përputhje me dispozitat e ligjit nr.8371, datë 9.7.1998 “Për Lidhjen e Marrëveshjeve dhe Traktateve Ndërkombëtare”. Në bazë të nenit 24 të ligjit “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve gjithashtu ka për detyrë administrimin dhe zbatimin e dispozitave të marrëveshjeve ndërkombëtare tatimore dhe përfaqësimin e vendit në bashkëpunimin dhe zgjidhjen e konflikteve me autoritetet tatimore të vendeve të tjera.

2. Sqarime të përgjithshme lidhur me taksimin e dyfishtë dhe marrëveshjet tatimore.

Çdo vend është i lirë të zgjedhë, të krijojë, të adoptojë dhe të zbatojë një sistem tatimor që ti përshtatet nevojave dhe zhvillimit të tij. Por, megjithë veçoritë që mund të kenë, sistemet tatimore përgjithësisht mbështeten në disa parime bazë, që janë krijuar me kohë dhe janë përsosur vazhdimisht nga zhvillimet botërore në teorinë dhe praktikën qindra vjeçare tatimore. Në funksion të qëllimit të këtij udhëzimi, në vijim, do të sqarojmë dy nga parimet më të rëndësishme ku janë mbështetur legjislacionet tatimore në shumicën e vendeve të botës:

2.1. Parimi i rezidencës. Termi “rezident”, që në kuptimin e ngushtë do të thotë “banor i përhershëm”, në gjuhën tatimore përdoret për të treguar individët apo shoqëritë (personat juridikë), të cilët në bazë të kriterëve të përcaktuara në legjislacionin e një shteti, konsiderohen subjekte tatimore të atij shteti, me përgjegjësi të plotë tatimore në atë shtet. Pra në kuptimin fiskal rezidenca e një tatimpaguesi lidhet me “vendbanimin e përhershëm për efekt tatimi”, prandaj në disa vende për të shprehur rezidencën tatimore përdoret termi “vendbanim fiskal”. Në përgjithësi, përcaktimi i rezidencës (vendbanimit fiskal) të tatimpaguesve në legjislacionet tatimore bazohet në kriteret e mëposhtme:

a) Për personat juridikë (shoqëritë):

- vendi ku ndodhet selia qendrore apo vendi i drejtimit efektiv të shoqërisë, pra shteti në territorin e të cilit ndodhet administrata qendrore e shoqërisë, ku zakonisht mblidhet dhe merr vendimet e biznesit bordi drejtues i shoqërisë;

- vendi i themelimit apo inkuorporimit, pra vendi në bazë të legjislacionit të të cilit shoqëria (kompania) është themeluar dhe regjistruar për të ushtruar aktivitetin si person juridik.

b) Për individët:

- vendi ku individ i ka një banesë të përhershme në dispozicion të tij;

- vendi ku interesat e tij jetike janë të lidhura më ngushtë (ku ka familjen dhe interesat ekonomike);

- vendi ku ai qëndron fizikisht në pjesën më të madhe të vitit (më shumë se 183 ditë) etj.

Në bazë të këtyre kriterëve përcaktohet shteti ku ndodhet “vendbanimi fiskal” apo “rezidenca” e shoqërisë apo e individit për pasojë edhe detyrimi i plotë për të paguar tatimet në atë shtet.

Në ligjin tonë nr.8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat” (i ndryshuar), neni 3, një individ konsiderohet rezident tatimor shqiptar nëse ka një vendbanim të qëndrueshëm në territorin e Republikës së Shqipërisë ose kur qëndron në Republikën e Shqipërisë për një periudhë që në total i kalon 183 ditë gjatë një viti kalendarik, ndërsa një person juridik konsiderohet rezident shqiptar kur

ka vendin e menaxhimit dhe selinë qendrore në Republikën e Shqipërisë.

Në bazë të “parimit të rezidencës” përparësi në trajtimin tatimor u jepet subjekteve dhe jo vendit ku realizohen të ardhurat. Të gjitha subjektet që konsiderohen rezidentë tatimorë të një shteti (që plotësojnë kriteret e vendosura për këtë qëllim nga legjislacioni i këtij shteti), qofshin individë apo persona juridikë (shoqëri), duhet të tatohen në këtë shtet për të gjitha të ardhurat që ato përfitojnë brenda apo jashtë territorit të atij shteti, pra edhe në vende të tjera. Një tatim i tillë quhet tatim mbi baza botërore ose tatim i rezidentëve për të ardhurat e realizuara në shkallë botërore. (Në ligjin shqiptar “Për tatimin mbi të ardhurat” ky parim mishërohet në nenin 7, paragrafi 1 për individët, dhe në nenin 17, paragrafi 1 për personat juridikë).

2.2. Parimi i burimit. Sipas këtij parimi të ardhurat apo fitimet e krijuara (realizuara) në një shtet, duhet të tatohen në këtë shtet pavarësisht nëse subjekti (individi ose shoqëria) janë ose jo rezidentë të këtij shteti. Po kështu, në bazë të parimit të burimit, pasuritë e ndodhura në një shtet (tokë, ndërtesa etj.) duhet të tatohen në këtë shtet, pavarësisht nëse pronari i tyre është ose jo rezident i këtij shteti. Pra parimi i burimit i jep përparësi vendit ku “prodhohen”, krijohen të ardhurat ose ku janë vendosur pasuritë, pavarësisht se këto të ardhura mund të përfitohen ose këto pasuri mund të zotërohen nga individë ose shoqëri të huaja, pra “jorezidentë” të atij vendi. Në ligjin shqiptar për tatimin mbi të ardhurat ky parim mishërohet në nenin 7 paragrafi 2 për individët dhe në nenin 17 paragrafi 2 për personat juridikë.

2.3. Kuptimi i taksimit të dyfishtë. Në shumicën e vendeve të botës dhe thuajse në të gjitha vendet e zhvilluara, legjislacioni tatimor ka sanksionuar si parimin e rezidencës edhe parimin e burimit. Pra kuptimi i parimeve të mësipërme do të shprehej:

a) individët dhe personat juridikë që konsiderohen rezidentë të një shteti në bazë të legjislacionit të tij, i nënshtrohen tatimit në këtë shtet për të ardhurat në total të realizuara në shkallë botërore, pra në këtë shtet dhe kudo gjetkë (parimi i rezidencës) dhe

b) individët dhe personat juridikë që nuk janë rezidentë të këtij shteti në bazë të legjislacionit të këtij shteti, (pra personat jorezidentë) i nënshtrohen tatimit në këtë shtet vetëm për të ardhurat që mund të realizojnë në këtë shtet (parimi i burimit).

I njëjti konkluzion do të arrihej nga interpretimi i neneve 7 dhe 17 të ligjit shqiptar “Për tatimin mbi të ardhurat”.

Në këto kushte individët apo shoqëritë rezidente të një shteti, që ushtrojnë aktivitete dhe realizojnë të ardhura në një shtet tjetër, për këto të ardhura tatohen dy herë një herë në vendin e rezidencës së tatimpaguesit (individi apo shoqërisë) dhe një herë në vendin e burimit të të ardhurave.

Shëmbull: Për të parë se si lind tatimi i dyfishtë le të supozojmë se një individ apo një shoqëri (person juridik) rezident i shtetit “X”, do të ushtrojë aktivitetet në Shqipëri:

a) në rastin e individit ai mund të jetë p.sh. një specialist, këshilltar rezident i shtetit “X”, që punon në një shoqëri shqiptare me kohë të kufizuar apo një ekspert i pavarur (avokat, inxhinier, mjek, etj) apo sportist ose artist, i cili nuk i plotëson kriteret për t’u konsideruar rezident tatimor shqiptar (ai qëndron në Shqipëri në total më pak se 183 ditë gjatë një viti tatimor dhe/ose ka interesat jetike në shtetin X), pra nuk është rezident shqiptar për qëllime tatimore. Meqenëse ky individ është rezident tatimor i shtetit “X”, në bazë të legjislacionit tatimor të këtij shteti ai tatohet në shtetin “X” për të ardhurat e tij në total të realizuara në atë shtet dhe kudo gjetkë, pra edhe për të ardhurat e realizuara në Shqipëri. Nga ana tjetër, për pjesën e të ardhurave të realizuara në Shqipëri, në bazë të ligjit për tatimin mbi të ardhurat (neni 7, paragrafi 2), ky individ do të tatohet në Shqipëri, për pagën apo shpërblime të ndryshme që merr për punën që ai bën në Shqipëri. Siç shihet të ardhurat e realizuara në Shqipëri tatohen dy herë, një herë në Shqipëri dhe pastaj në shtetin “X”. Pra një herë në vendin ku realizohen të ardhurat dhe një herë në vendin ku ka rezidencën tatim-paguesi. Po kështu individë, rezidentë tatimorë të shtetit X, mund të realizojnë të ardhura nga interesat për depozita që kanë në banka rezidente shqiptare apo të ardhura nga dividendët për aksione që mund të zotërojnë në shoqëri rezidente shqiptare, dhe, në këto raste, interesat apo dividendët tatohen dy here: një herë me tatim në burim në Shqipëri (vendi ku krijohen të ardhurat) dhe një herë me tatim mbi të ardhurat në shtetin X (vendi ku ka rezidencën tatimpaguesi);

b) në rastin e shoqërisë, ajo mund të jetë një shoqëri tregtare që është rezidente e Shtetit X, në përputhje me kriteret e vendosura nga legjislacioni i atij shteti. Le të supozojmë se kjo shoqëri quhet “COMERC - X - SA”. Ndërkohë shoqëria “COMERC - X - SA” krijon në Shqipëri një degë ose një zyrë përfaqësimi (që gjithashtu mund të jetë një pikë shitje, një shesh ndërtimi, si nënkontraktor në

zbatimin e një projekti ndërtimi apo instalimi etj.), nëpërmjet së cilës realizon fitime edhe në Shqipëri. Në bazë të legjislacionit tatimor të shtetit “X”, shoqëria “COMERC - X - SA” tatohet në shtetin “X” për fitimet në total të realizuara në shtetin “X” dhe në çdo shtet tjetër, pra edhe për fitimet e realizuara në Shqipëri (parimi i rezidencës). Nga ana tjetër për fitimet e realizuara në vendin tonë, në bazë të ligjit për tatimin mbi të ardhurat, neni 17 paragrafi 2, fitimet e realizuara në territorin e Republikës së Shqipërisë do të taten në Shqipëri (parimi i burimit). Edhe në këtë rast pjesa e të ardhurave e realizuar në Shqipëri, tatohet dy herë: një herë në Shqipëri (vendi ku realizohen të ardhurat - vendi i burimit) dhe pastaj në shtetin “X” (vendi ku ka rezidencën tatimpaguesi, pra shoqëria në fjalë). Po kështu kompani të huaja mund të realizojnë të ardhura nga interesat për hua që mund t’i kenë dhënë kompanive shqiptare, të ardhura nga e drejta e përdorimit të patentave apo markave tregtare, të ardhura nga dividendët për aksione që mund të zotërojnë në shoqëri shqiptare, dhe, në të gjitha rastet, respektivisht, interesat, honoraret apo dividendët taten njëherë në vendin ku krijohen (me tatim në burim në Shqipëri) dhe një herë në vendin ku është rezidente kompania përfituese (në shtetin X).

Siç shihet nga të dy shembujt e dhënë, “tatim të dyfishtë” kemi kur e njëjta e ardhur, në duart e të njëjtit person, tatohet dy herë: një herë në vendin ku realizohen të ardhurat dhe një herë në vendin ku ka rezidencën tatimpaguesi. Tatimi i dyfishtë mund të krijohet edhe kur të dy shtetet pretendojnë që, në bazë të kriterëve të legjislacioneve të brendshme (që mund të jenë të ndryshme), një individ apo një shoqëri konsiderohet rezidente në të dy shtetet (rezidencë e dyfishtë) dhe i nënshtrohet detyrimit të plotë tatimor në të dy shtetet. Pra, në këto kushte, vetëm fakti që aktiviteti i individit apo i shoqërisë është i shtrirë në dy shtete, bën që të ardhurat e realizuara prej tyre të taten dy herë.

2.4. Nevoja për përfundimin e marrëveshjeve tatimore. Tatimet e dyfishta bëhen pengesë për lëvizjen e individëve, shoqërive, kapitaleve dhe investimeve të ndërsjella nga një shtet tek tjetri. Janë pikërisht marrëveshjet ndërkombëtare bilaterale për eliminimin e taksimit të dyfishtë të cilat, nëpërmjet dispozitave që krijojnë për palët nënshkruese, eliminojnë tatimin e dyfishtë duke përcaktuar se cili nga shtetet ka të drejtë të tatojë të ardhura të caktuara të një subjekti të caktuar, apo duke e ndarë këtë të drejtë mes të dy shteteve, por pa e rënduar subjektin me tatim të dyfishtë. Konventat ose marrëveshjet për eliminimin e tatimeve të dyfishta lidhur me tatimet mbi të ardhurat dhe mbi kapitalin, që në praktikë shpesh emërtohen marrëveshje të tatimeve të dyfishta ose thjesht marrëveshje tatimore, krijojnë një bazë të plotë ligjore për të gjithë individët apo shoqëritë që bëhen objekt tatimi në të dy shtetet midis të cilave përfundohet marrëveshja. Këto marrëveshje kanë gjithashtu si qëllim edhe shmangien e evazionit fiskal nga individët apo shoqëritë që kanë aktivitete në të dy shtetet mes të cilave përfundohet marrëveshja. Në këto kushte, këto marrëveshje kanë një rol të rëndësishëm në kompleksin e faktorëve që garantojnë, favorizojnë dhe stimulojnë marrëdhëniet ekonomiko-tregtare ndërkombëtare. Nevoja e përfundimit të marrëveshjeve tatimore rritet shumë sidomos me rritjen e vazhdueshme të shoqërive ndërkombëtare (multinacionaleve), që ushtrojnë aktivitete njëkohësisht në disa vende (rreth 60 për qind e tregtisë botërore sot zhvillohet nga multinacionalet). Duke pasur aktivitete në disa shtete, multinacionalet qëndrojnë nën juridiksionin e legjislacioneve tatimore të disa vendeve, gjë që e komplikon dhe vështirëson mbledhjen e tatimeve në secilin shtet. Në të tilla raste mund të lindin tatime të dyfishta, por edhe evazion fiskal gjë që e bën të domosdoshme përfundimin e marrëveshjeve tatimore. Rritja e vazhdueshme e lëvizjes së individëve që ushtrojnë aktivitete biznesi në dy ose më shumë shtete si artistë, sportistë, avokatë, mjekë, këshilltarë etj., zotërimi i pasurive nga individë të ndryshëm në disa shtete etj., gjithashtu rrisin nevojën e përfundimit të marrëveshjeve për eliminimin e tatimeve të dyfishta dhe shmangien e evazionit fiskal.

### 3. Marrëveshjet tatimore të përfunduara nga Shqipëria.

3.1. Marrëveshjet tatimore të përfunduara nga vendi ynë janë bazuar në një projekt tip të miratuar nga qeveria, i cili është hartuar duke u bazuar modele ndërkombëtare bazë të hartuara për këtë qëllim nga Organizata e Kombeve të Bashkuara (OKB) dhe nga Organizata për Bashkëpunimin Ekonomik dhe Zhvillimin (OECD). Sigurisht që në secilën marrëveshje bilaterale mbahen parasysh veçoritë e legjislacioneve tatimore dhe të mardhënieve ekonomike e tregtare midis të dy vendeve që përfundojnë marrëveshjen. Pasi marrëveshjet tatimore nënshkruhen nga personat e autorizuar të të dy vendeve, ato miratohen nga qeveria dhe ratifikohen nga Kuvendi, dhe, pasi një gjë e tillë është njoftuar zyrtarisht nga të dy vendet, marrëveshja hyn në fuqi dhe ka efekt nga 1 janari i vitit pasardhës (si përcaktohet saktësisht në çdo marrëveshje), duke u bërë pjesë e legjislacionit tatimor. Duke pasur parasysh modelin shqiptar të marrëveshjeve tatimore dhe marrëveshjet e deritanishme të përfunduara nga vendi ynë, dispozitat e tyre afrohen më shumë me modelin e OECD-së të vitit 1997 dhe me

modelin e Kombeve të Bashkuara të vitit 2001.

3.2. Vendi ynë deri tani ka nënshkruar marrëveshje tatimore me Poloninë, Rumaninë, Malajzinë, Hungarinë, Turqinë, Çekinë, Rusinë, Maqedoninë, Kroacinë, Italinë, Bullgarinë, Suedinë, Norvegjinë, Greqinë, Zvicrën, Maltën, Francën dhe Belgjikën. Gjithashtu janë negociuar marrëveshjet me Hollandën, Egjiptin dhe Jugosllavinë, si edhe kanë filluar procedurat për negocimin e Marrëveshjeve me Kinën, ShBA, Gjermaninë, Austrinë etj.

4. Baza e interpretimit të dispozitave të marrëveshjeve tatimore dhe autoritetet kompetente për zbatimin e tyre

4.1. Dispozitat e marrëveshjeve tatimore do të interpretohen duke u bazuar në dispozitat konkrete për çdo marrëveshje dhe në udhëzimet e Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve. Në raste vështirësish në interpretim do të konsultohen edhe komentet e modelit të OECD-së (kryesisht të vitit 1997) dhe modelit të Kombeve të Bashkuara të vitit 2001. Dispozita të veçanta të përfshira në marrëveshjet bilaterale për shkak të veçorive ligjore apo proceduriale të njërit apo të dy shteteve kontraktuese do të interpretohen në përputhje me dispozitat e legjislacioneve të brendshme duke respektuar edhe udhëzimet e përgjithshme të dhëna në komentet e modeleve të OECD-së apo të Kombeve të Bashkuara.

4.2. Dispozitat e këtij udhëzimi do të përdoren për interpretimin e të gjitha marrëveshjeve tatimore të përfunduara apo që do të përfundohen nga vendi ynë, me kusht që dispozitat konkrete në çdo marrëveshje të mos kenë veçori apo ndryshime, interpretimi i të cilave do të bazohet në formulimin konkret të dispozitës, në legjislacionin e brendshëm të shtetit që bën aplikimin, si edhe në modelet ndërkombëtare nëse e përmbajnë një dispozitë të tillë.

4.3. Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve (DPT) është përgjegjëse për zbatimin e dispozitave të marrëveshjeve tatimore. DPT përcakton procedurat e zbatimit të këtyre marrëveshjeve. Si pjesë e këtyre procedurave janë formularët që vërtetojnë rezidencën e tatimpaguesve shqiptarë, si dhe formularët e aplikimit të marrëveshjes tatimore. Bashkëngjitur janë modelet e këtyre formularëve.

a) Vërtetimi i rezidencës u lëshohet tatimpaguesve të regjistruar në organet tatimore shqiptare nga DPT, pas kërkesës me shkrim të tatimpaguesit, dhe pasi bëhen verifikimet e nevojshme në degën e tatimeve ku ai është i regjistruar. Një kopjo e përgjigjes që i jepet tatimpaguesit i dërgohet për njoftim degës së tatimeve ku është i regjistruar tatimpaguesi, në mënyrë që dega të bëjë verifikimin e deklaramit të të ardhurave që ky tatimpagues ka realizuar në shtetin tjetër. Vërtetimi i rezidencës i shërben tatimpaguesit për të vërtetuar se paguan tatimet për të ardhurat globale në Shqipëri, në mënyrë që organi tatimor i shtetit të huaj ku ai ka realizuar të ardhurat të bëjë aplikimin e marrëveshjes (duke aplikuar, sipas rastit, tarifën e reduktuar ose duke mos i tatuar ato të ardhura);

b) Formulari i aplikimit të marrëveshjes u lëshohet subjekteve që kanë transaksione me persona të cilët janë rezidentë në vendet me të cilat është përfunduar marrëveshja. Pra ky formular ka për qëllim aplikimin e marrëveshjes për të ardhura me burim në Shqipëri (paguesi është tatimpagues shqiptar) të realizuara nga persona që janë rezidentë në shtetin me të cilin është përfunduar marrëveshja tatimore. Ky formular plotësohet për çdo pagesë (transaksion) nga paguesi, përfituesi i të ardhurave, si dhe nga autoriteti tatimor i vendit të huaj, rezident i të cilit është tatimpaguesi. DPT ka të drejtë të autorizojë plotësimin e formularit për një periudhë kohe (p.sh. 3 muaj, 6 muaj apo vjetore), por në raste të tilla në formular duhet të jepen referenca të të gjitha pagesave, duke e shoqëruar me fotokopjo të faturave. Formulari (në 4 kopjo, i plotësuar në përputhje me udhëzimet e dhëna në formular), i shoqëruar me një kërkesë me shkrim, dërgohet në Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve. Drejtoria e përgjithshme e Tatimeve njofton degën e tatimeve ku është i regjistruar paguesi i të ardhurave, duke bërë edhe referimet dhe interpretimet e nevojshme për zbatimin e dispozitave të Marrëveshjes.

4.4. Dega e tatimeve në çdo rast zbaton me përpikmëri legjislacionin e brendshëm. Dega e tatimeve i përciell në DPT kërkesat e marra nga subjektet për aplikimin e marrëveshjeve tatimore, dhe mund të zbatojnë dispozitat e marrëveshjeve tatimore vetëm pas marrjes së një shkrese zyrtare nga DPT, e cila duhet të bazohet në dispozitat konkrete të një marrëveshje që është në fuqi.

4.5. Në rastet kur dispozitat e marrëveshjes tatimore bien në kundërshtim me dispozitat e legjislacionit të brendshëm, dispozitat e marrëveshjes kanë përparësi.

4.6. Në interpretimet që vijnë është krijuar një model i marrëveshjes tatimore (midis Shqipërisë dhe shtetit X), që afrohet më shumë me marrëveshjet e përfunduara nga vendi ynë. Një kopjo e këtij modeli i bashkëngjitet këtij udhëzimi. Sigurisht aplikimi i marrëveshjes në rastet praktike

do të bazohet në dispozitat konkrete në fuqi të çdo marrëveshjeje.

5. Struktura bazë e marrëveshjeve për shmangien e tatimeve të dyfishta

5.1. Një marrëveshje tatimore mund të ndahet në 7 pjesë (kapituj):

I- Fushëveprimi i marrëveshjes (nenet 1 dhe 2)

II- Përcaktime apo përkufizime të koncepteve dhe termave (nenet 3-5)

III- Tatimi i të ardhurave (nenet 6-21)

IV- Tatimi i kapitalit (neni 22)

V- Metodatat për eliminimin e tatimit të dyfishtë (neni 23)

VI- Dispozita të veçanta (nenet 24 – 27)

VII- Dispozita përfundimtare (nenet 28 – 29)

Në vijim do të japim disa sqarime më të hollësishme për dispozitat kryesore të marrëveshjeve tatimore.

6. Neni 1 “Personat që mbulon marrëveshja (Konventa)”

Ky nen sanksionon faktin që marrëveshja aplikohet ndaj personave që janë rezidentë tatimorë të njerit apo të dy shteteve kontraktuese, pavarësisht nga nacionaliteti apo nënshtetësia. Marrëveshja aplikohet ndaj personave fizikë apo juridikë që i nënshtrohen detyrimit të plotë tatimor në njërin shtet kontraktues, dhe që, për të ardhura të realizuara apo kapital të zotëruar në shtetin tjetër kontraktues, mund të bëhen subjekt i tatimit edhe në këtë shtet tjetër.

7. Neni 2 “Tatimet që mbulon marrëveshja”

Ky nen sanksionon faktin që marrëveshja aplikohet ndaj tatimeve direkte mbi të ardhurat dhe mbi kapitalin (nacionale apo vendore) në secilin shtet kontraktues, duke dhënë edhe listën e tatimeve kryesore ndaj të cilave zbatohen dispozitat e marrëveshjes. Marrëveshja gjithashtu do të zbatohet për çdo tatim thelbësisht të ngjashëm që mund të sanksionohet në secilin shtet kontraktues pas datës së nënshkrimit të marrëveshjes, si shtesë apo amendim i tatimeve ekzistuese. Autoritetet kompetente të shteteve kontraktuese duhet të njoftojnë njeri-tjetrin për çdo ndryshim në legjislacionin tatimor që ka efekt në zbatimin e marrëveshjes.

8. Neni 3 “Përcaktime (përkufizime) të përgjithshme”

8.1. Ky nen bën përkufizimin e disa termave të përgjithshëm të përdorur në marrëveshje. Kështu :

- termi “person” përdoret në një kuptim të gjerë dhe përfshin individët, personat fizikë tregtarë, personat juridikë (përfshirë shoqëritë dhe ortakëritë);

- termi “shoqëri” (kompani) përfshin çdo person juridik apo ent ligjor që trajtohet si subjekt veçantë për qëllime tatimore;

- termi “trafik (transport) ndërkombëtar” përfshin aktivitetet e transportit me anije, avionë, apo mjete të transportit rrugor që operohen në transportin ndërkombëtar të mallrave apo pasagjerëve (midis shteteve kontraktuese) nga një kompani që është rezidente e njerit shtet kontraktues;

- termi “nënshtetas i një shteti kontraktues” nënkupton individët apo personat fizikë që zotërojnë nënshtetësinë e një shteti kontraktues në bazë të ligjeve të atij shteti apo personat juridikë që e marrin statusin si të tillë nga legjislacioni i atij shteti;

- përkufizimi i disa termave të rëndësishëm si “rezidenti”, “selia e përhershme”, “dividendi”, “interesat”, “honoraret” dhe “shërbimet personale të pavarura” bëhen direkt në nenet përkatëse të marrëveshjes.

8.2. Në paragrafin 2 të nenit 3 sanksionohet fakti që për termat e papërkufizuar në marrëveshje do të merret kuptimi që u jepet atyre termave në legjislacionin e brendshëm të shtetit lidhur me tatimet e të cilit aplikohet marrëveshja, në përputhje me kontekstin e dispozitës së marrëveshjes ku ato përdoren. Kuptimi i këtyre termave i përdorur në legjislacionin tatimor do të ketë përparësi ndaj kuptimeve që mund t’u jenë dhënë këtyre termave në ligje të tjera të atij shteti.

9. Neni 4 “Rezidenti”

9.1. Ky nen ka rëndësi për përcaktimin e personave ndaj të cilëve do të aplikohet marrëveshja, për zgjidhjen e rasteve të rezidencës së dyfishtë (kur në bazë të legjislacioneve të brendshme një person mund të konsiderohet rezident i të dy shteteve), si dhe për zgjidhjen e rasteve të taksimit të dyfishtë në shtetin e rezidencës dhe në shtetin e burimit të të ardhurave.

9.2. Në paragrafin e parë të këtij neni jepet përkufizimi i “Rezidentit të një shteti kontraktues” që nënkupton çdo person (individ apo shoqëri) që në bazë të legjislacionit të atij shteti ka përgjegjësi të plotë tatimore në atë shtet (i nënshtrohet tatimit për të gjitha të ardhurat në atë shtet, pavarësisht nga

vendi ku realizohen të ardhurat). Për qëllime të marrëveshjes tatimore, termi rezident i një shteti kontraktues gjithashtu përfshin edhe vetë shtetin kontraktues dhe çdo nën-ndarje politike apo autoritet lokal të tij.

9.3. Në paragrafin 2 të këtij neni jepen kriteret për përcaktimin e rezidencës së individëve dhe radha e aplikimit të tyre. Aplikimi i kriterëve bëhet hap pas hapi me radhën (prioritetin) e dhënë në marrëveshje, d.m.th. individ i konsiderohet rezident i shtetit kontraktues në të cilin ai ka një banesë të përhershme në dispozicion të tij, por nëse ai individ ka një banesë të përhershme në dispozicion të tij në të dy shtetet kontraktuese (ose në asnjërin prej tyre) atëherë ai konsiderohet rezident i shtetit ku ka qendrën e interesave jetike (ku ka interesat personale dhe ekonomike) dhe, nëse shteti ku ka qendrën e interesave jetike nuk mund të përcaktohet, pra ky kriter nuk e bën të mundur përcaktimin e rezidencës, atëherë kalohet në kriterin vijues që është “vendi ku individ i qëndron zakonisht”, dhe, nëse edhe kjo nuk e bën të mundur përcaktimin e rezidencës atëherë kalohet në kriterin tjetër që është “nënshitetësia”, dhe nëse individ është nënshitetas i të dy shteteve apo i asnjërit prej tyre, atëherë autoritetet kompetente të shteteve kontraktuese do ta zgjidhin çështjen me mirëkuptim reciprok në përputhje me procedurat e përcaktuara në nenin që bën fjalë për “Procedurat e mirëkuptimit reciprok”.

9.4. Në paragrafin 3 të këtij neni jepen kriteret e përcaktimit të rezidencës për personat juridikë. Në rastet kur nga të dy vendet mund të pretendohet rezidenca e të njëjtit preson juridik, zakonisht marrëveshja tatimore përparësi i jep vendit ku personi ka qendrën e tij të menaxhimit efektiv të biznesit, pra vendi ku realizohen menaxhimi dhe kontrolli, ku merren vendimet kyçe të domosdoshme për realizimin e biznesit (vendi i regjistrimit mund të jetë kriter tepër formal).

#### 10. Neni 5 “Selia e përhershme”

10.1. Ky është një nga nenet më të rëndësishëm të marrëveshjes tatimore, pasi qëllimi kryesor i përdorimit të konceptit të “selisë së përhershme” është përcaktimi i së drejtës së një shteti kontraktues për të tatuar fitimet e një sipërmarrjeje të shtetit tjetër kontraktues. Në bazë të nenit 7 të marrëveshjes një shtet kontraktues mund të tatojë fitimet e një sipërmarrjeje të shtetit tjetër kontraktues kur kjo sipërmarrje ka një seli të përhershme në shtetin kontraktues të përmendur në fillim.

10.2. Paragrafi 1 jep një përkufizim të përgjithshëm të termi “seli e përhershme” që është një vend fiks biznesi nëpërmjet të cilit ushtrohet në njërin shtet kontraktues tërësisht ose pjesërisht biznesi i një sipërmarrjeje të shtetit tjetër kontraktues. Ky përkufizim përmban ekzistencën e një “vendi fiks biznesi” pra e një ambienti të caktuar apo pajisjeve që një sipërmarrjeje rezidente e një shteti kontraktues përdor në shtetin tjetër kontraktues për të ushtruar biznesin e saj me një shkallë të caktuar permanence. Nuk ka rëndësi nëse ky vend, këto ambiente apo këto pajisje zotërohen, janë marrë me qira apo i janë vënë në dispozicion në forma të tjera sipërmarrjes. Rëndësi ka gjithashtu fakti që selia e përhershme është pjesë e biznesit aktiv të sipërmarrjes së huaj, pra ajo kontribuon në fitimet e sipërmarrjes. Duke qenë një vend fiks aktiv biznesi presupozohet që selia e përhershme tashmë ka një pjesëmarrje direkte edhe në jetën ekonomike të shtetit ku ndodhet dhe normalisht fitimet e saj duhet të taten në atë shtet. Pra koncepti i selisë së përhershme të një sipërmarrjeje të huaj në Shqipëri lidhet me një prezencë fizike relativisht permanente të sipërmarrjes së huaj, nëpërmjet të cilës ajo ushtron biznes dhe, kjo sipërmarrje do të tatohet në Shqipëri për të ardhurat e realizuara nga ajo ose që i atribuohen aktivitetit të selisë së përhershme në Shqipëri.

10.3. Paragrafi 2 i këtij neni jep disa shembuj tipikë (që nuk janë të vetmet) si “një vend menaxhimi”, “një degë”, “një zyrë”, “një fabrikë”, “një punishte”, “një minierë” etj., që mund të konsiderohen një seli e përhershme, nëse plotësojnë kriteret e paragrafit 1.

10.4. Paragrafi 3 trajton veçmas sheshet e ndërtimit, konstruksionet apo instalimet të cilat mund të konsiderohen një seli e përhershme, nëse zgjasin më shumë se një periudhë kohe që përcaktohet në këtë paragraf (zakonisht 9 muaj ose 1 vit). Punimet përgatitore si përgatitja e sheshit të ndërtimit etj. përfshihen në kohëzgjatjen e ndërtimit. Ndërprerjet sezonale apo ndërprerje të tjera të përkohshme gjithashtu do të llogariten në përcaktimin e jetëgjatësisë së sheshit të ndërtimit apo konstruksionit. Ky paragraf mbulon edhe ndërtimin e rrugëve, urave, tubacioneve etj. Në rastin e subjekteve (kontraktorë kryesorë) të cilët nënkontraktajnë subjekte të tjera jorezidente për zbatimin e një projekti, koha e shpenzuar nga nënkontraktorët në atë projekt llogaritet në përcaktimin e kohës së kontraktorit kryesor. Nga ana tjetër nëse punimet e nënkontraktorit zgjasin për një periudhë që kalon, sipas rastit, 9 ose 12 muaj, atëherë ky nënkontraktor konsiderohet se ka një seli të përhershme dhe fitimet që i atribuohen asaj taten në shtetin ku zbatohet projekti.

10.5. Paragrafi 4 liston një numur aktivitete biznesore që trajtohen si përjashtim nga rregulli

i përgjithshëm i paragrafit 1 dhe që nuk konsiderohen seli e përhershme edhe pse këto aktivitete ushtrohen nëpërmjet një vendi fiks biznesi. Përgjithësisht këto aktivitete konsiderohen të një karakteri përgatitor ose ndihmës për biznesin kryesor të sipërmarrjes. Që të gjykohet për një aktivitet se është i një karakteri përgatitor ose ndihmës duhet njohur më parë aktiviteti kryesor i sipërmarrjes.

10.6. Paragrafi 5 trajton rastin që një sipërmarrje e një shteti kontraktues konsiderohet se ka një seli të përhershme në shtetin tjetër kontraktues, nëse ushtron biznes atje nëpërmjet një “agjenti (ndërmjetësi) të varur”, edhe pse pa një vend fiks biznesi në kuptimin e paragrafëve 1 dhe 2. Pra ky paragraf i jep të drejtë shtetit ku ushtron aktivitetin agjenti i varur, të tatojë të ardhurat e sipërmarrjes së huaj që realizohen nëpërmjet këtij personi (agjentit të varur). Agjenti i varur mund të jetë një individ apo një kompani (zyrë përfaqsimi) që ushtron biznesin e sipërmarrjes.

10.7. Paragrafi 6 thekson faktin se “agjentët e pavarur” (brokera, komisionerë të pavarur) nuk konsiderohen “seli e përhershme” e sipërmarrjes së huaj. Agjenti i pavarur (qoftë individ apo shoqëri) është rezident i shtetit ku ndodhet dhe tatohet aty, por për natyrën e biznesit ky agjent shpesh vepron si agjent ndërmjetës i sipërmarrjeve të huaja, dhe nuk mjafton ky fakt që të konsiderohet se sipërmarrja e huaj ka një seli të përhershme në Shqipëri (pse ushtron biznes nëpërmjet agjentit të pavarur) dhe fitime të kësaj sipërmarrje të huaj të tatohen në Shqipëri.

10.8. Paragrafi 7 sqaron faktin se ekzistenca e një filiali të një kompanie të huaj nuk përbën në vetvete arsye të mjaftueshme për ta konsideruar filialin seli të përhershme të kompanisë mëmë, pasi filiali përbën një ent ligjor të pavarur për efekt tatimi në vendin ku ai ndodhet (pra, filiali është rezident i vendit ku ndodhet). Por mund të ndodhë që kompania mëmë të ushtrojë pjesë të biznesit të saj nëpërmjet një selie të përhershme (që mund të jetë edhe në ambientet e filialit) dhe të tatohen në Shqipëri edhe pjesë të fitimit të kompanisë mëmë që i atribuohen selisë së përhershme.

#### 11. Neni 6 “Të ardhurat nga pasuria e paluajtshme”

11.1. Ky nen trajton vetëm të ardhurat që një rezident i njerit shtet kontraktues realizon nga zotërimi i pasurive të paluajtshme në shtetin tjetër kontraktues. Pra ai nuk zbatohet ndaj të ardhurave nga pasuria e paluajtshme e ndodhur në shtetin kontraktues ku përfituesi është rezident.

11.2. Paragrafi 1 jep të drejtën e tatimit të të ardhurave nga pasuria e paluajtshme shtetit të burimit, pra shtetit në të cilin ndodhet pasuria e paluajtshme që “prodhon” këto të ardhura.

11.3. Paragrafi 2 sanksionon faktin që termi “pasuri e paluajtshme” do të ketë kuptimin që i jepet nga legjislacioni i shtetit kontraktues ku ndodhet pasuria në fjalë, gjë që shmang diferencat në interpretim të faktit nëse një aset apo e drejtë do të konsiderohet si pasuri e paluajtshme ose jo. Megjithatë ky paragraf jep një listë specifike të disa aseteve dhe të drejtave që gjithmonë konsiderohen pasuri të paluajtshme. Ky paragraf gjithashtu sanksionon faktin se anijet, avionët dhe mjetet e transportit rrugor nuk konsiderohen pasuri të paluajtshme.

11.4. Paragrafi 3 sanksionon faktin se rregulli i përgjithshëm (tatimi në vendin e burimit) do të zbatohet pavarësisht nga forma e shfrytzimit apo përdorimit të pasurive të paluajtshme.

11.5. Paragrafi 4 qartëson faktin se dispozitat e paragrafëve 1 dhe 3 të këtij neni do të zbatohen gjithashtu ndaj të ardhurave nga pasuria e paluajtshme e sipërmarrjeve (personave juridikë të çdo forme). Pra mund të ndodhë që një sipërmarrje e huaj të mos plotësojë kushtet e nenit 5 lidhur me selinë e përhershme, pra ajo nuk ka një seli të përhershme nëpërmjet së cilës ushtron biznes në Shqipëri, dhe nuk tatohet në Shqipëri në bazë të nenit 7 të marrëveshjes, por mund të zotërojë pasuri të paluajtshme apo të drejta të lidhura me to dhe në bazë të nenit 6 paragrafët 1 dhe 4, të ardhurat e realizuara nga këto pasuri tatohen në Shqipëri.

#### 12. Neni 7, “Të ardhurat biznesore”

12.1. Ky nen në shumë aspekte është një vazhdim apo plotësim i nenit 5 (Selia e përhershme). Siç është përmendur më lart, koncepti i selisë së përhershme në marrëveshjet tatimore përdoret për të përcaktuar nëse të ardhura të caktuara do të tatohen ose jo në vendin ku krijohen. Kur një sipërmarrje e një shteti kontraktues (me të cilin është përfunduar marrëveshje tatimore) ushtron biznes në Shqipëri, atëherë për të zbatuar marrëveshjen tatimore duhen bërë dy pyetje: e para, a ka kjo sipërmarrje e huaj një seli të përhershme në Shqipëri? (në bazë të kriterëve të dhëna në nenin 5) dhe nëse përgjigja është po, atëherë vazhdohet me pyetjen e dytë: Cili është fitimi i tatueshëm (nëse ka) që sipërmarrja e huaj ka realizuar nëpërmjet selisë së përhershme në Shqipëri?

12.2. Paragrafi 1 lidhet me të dyja pyetjet e sipërpërmendura. Së pari ai riafirmon parimin e marrëveshjeve tatimore se një sipërmarrje e një shteti kontraktues nuk do të tatohet në shtetin tjetër kontraktues përveç rastit kur kjo sipërmarrje ushtron biznes në këtë shtet tjetër nëpërmjet një selie të

përherëshme të vendosur aty. Së dyti, dhe më e rëndësishmja, është dispozita e fjalisë së dytë, që thotë se kur një sipërmarrje e njërit shtet kontraktues ushtron biznes në shtetin tjetër kontraktues nëpërmjet një selie të përherëshme atëherë ky shtet tjetër (pra shteti ku ndodhet selia e përherëshme) mund t'i tatojë fitimet e sipërmarrjes, por vetëm atë pjesë të tyre që i atribuohen selisë së përherëshme (pra fitimet që realizohen nga selia e përherëshme).

12.3. Në paragrafin 2 jepet parimi bazë i alokimit apo llogaritjes së fitimeve të selisë së përherëshme, që bazohet në gjykimin e njësisë biznesore të pavarur. Pra llogaritja e fitimit të selisë së përherëshme bazohet në nivelin e fitimit që selia e përherëshme do të realizonte nëse do ta kishte ushtruar biznesin e pavarur nga kompania qendrore. Ky është parimi “arm’s length” thelbi i të cilit në Shqip mund të shprehej “parimi i transaksioneve biznesore midis palëve të pavarura, të bazuara në konkurrencën e ndershme të tregut”, i cili trajtohet me hollësi në nenin 9. Në shumicën e rasteve, sidomos në bizneset e mëdha serioze të cilat janë të interesuara të evidentojnë rentabilitetin e degëve, llogaritë tregtare të selive të përherëshme (të degëve) merren si bazë në përcaktimin e fitimeve të selisë së përherëshme, sigurisht kur ato janë të bazuara në realitetin biznesor të selisë së përherëshme dhe kompanisë qendrore apo pjesëve të tjera të grupit. Në mungesë të llogarive të tilla të rregullta, apo kur ka rregullime artificiale (transferim çmimi) të pabazuara në vlerën reale të transaksioneve, për llogaritjen e fitimit të selisë së përherëshme, administrata tatimore përdor metoda indirekte të bazuara në parimin “arm’s length” (sikur dega të ishte e pavarur nga mëma), dhe në çmimet reale të tregut, por duke e lidhur gjykimin sa më shumë me faktet dhe rrethanat e biznesit konkret të selisë së përherëshme. Në pamundësi për gjetjen e vlerave të krahasueshme të transaksioneve (pra një çmim krahasues malli apo shërbimi) administrata tatimore mund të përdorë norma mesatare të rentabilitetit të degës (si përqindje mbi xhiron), por përsëri duke e lidhur gjykimin sa më shumë me faktet dhe rrethanat e biznesit konkret të selisë së përherëshme. Në transaksionet midis kompanisë qendrore dhe selisë së përherëshme (degës), për të shmangur abuzimet, gjithmonë duhet të mbahet parasysh shkalla e domosdoshmërisë biznesore të llojit dhe masës së shpenzimit apo pagesës për atë transaksion, pasi mund të ndodhë që transaksione të caktuara të konstruktohen vetëm për qëllime të shmangies së tatimit dhe jo për nevoja të biznesit. Dhe nëse është kështu, pjesërisht apo tërësisht vlera e transaksionit nuk njihet si shpenzim i lejuar për efekt të llogaritjes së fitimit të tatueshëm të selisë së përherëshme.

12.4. Paragrafi 3 sqaron më tej parimin bazë të dhënë në paragrafin 2 lidhur me shpenzimet e selisë së përherëshme. Ky paragraf specifikon faktin se në llogaritjen e fitimit të selisë së përherëshme do të njihen si shpenzime të lejuara për efekt tatimi vetëm shpenzimet që janë kryer për qëllime të biznesit të selisë së përherëshme. Në disa raste mund të jetë e nevojshme të përdoren metoda indirekte për vlerësimin apo kalkulimin e shpenzimeve të lejuara. Psh. në rastin e shpenzimeve të përgjithshme administrative të kryera në zyrat qendrore të sipërmarrjes jashtë që lidhen edhe me biznesin e selisë së përherëshme (degës) mund të gjykohet e arësyeshme që nga shpenzimet administrative në total ti alokohet selisë së përherëshme pjesa e shpenzimeve që duhet “të përballohen” prej saj për efekt tatimi, duke u bazuar në raportin e xhiros (apo të fitimit bruto) së selisë së përherëshme me xhiron totale të kompanisë. Paragrafët 2 dhe 3 shpesh aplikohen të lidhur. Paragrafi 3 tregon se në përcaktimin e fitimeve të një selie të përherëshme, shpenzime të caktuara duhet të njihen si të zbritshme, ndërsa paragrafi 2 jep faktin se fitimet e përcaktuara në përputhje me rregullin e dhënë në paragrafin 3 duhet të jenë ato që do të realizonte një sipërmarrje e pavarur që do të ushtronte aktivitete të njëjta ose të ngjashme në rrethana të njëjta apo të ngjashme me ato të selisë së përherëshme. Pra ndërsa paragrafi 3 jep një rregull për përcaktimin e fitimeve të një selie të përherëshme, paragrafi 2 kërkon që fitimet e përcaktuara në këtë mënyrë t'i korrespondojnë fitimeve që do të kishte realizuar një sipërmarrje e pavarur në rrethana të njëjta.

12.5. Paragrafi 4 trajton rastet kur përcaktimi i fitimeve të selisë së përherëshme nuk bëhet bazuar në llogaritë e veçanta të selisë së përherëshme apo vlerësimet sipas parimit “arm’s length”, por bëhet thjesht duke ndarë fitimet totale të sipërmarrjes bazuar në formula të ndryshme. Kjo metodë ndryshon nga ato që jepen në paragrafin 2, pasi ajo bazohet në ndarjen e fitimeve totale të sipërmarrjes midis pjesëve të veçanta të saj (përfshirë selinë e përherëshme). Ky paragraf thekson faktin se, nëse një metodë e tillë përdoret zakonisht në ato lloje biznesesh, ajo të aplikohet në mënyrë të vazhdueshme, pavarësisht nga rezultatet. Por duhet theksuar se, në përgjithësi, metodat direkte (bazuar në të ardhurat dhe shpenzimet faktike të degës) janë më të sakta dhe u duhet dhënë përparësi.

12.6. Paragrafi 5 lidhet me një nga përjashtimet apo rastet që nuk konsideroheshin seli të



përherëshme të listuara në paragrafin 4 të nenit 5, që janë pikërisht zyrat e blerjes së mallrave apo të mbledhjes së informacionit për sipërmarrjen. Paragrafi 5 i nenit 7 sqaron faktin se nëse një seli e përherëshme, krahas biznesit normal të saj (për të cilin tatohet normalisht), gjithashtu realizon blerje mallrash për selinë qendrore (për sipërmarrjen, seli e përherëshme e së cilës është), fitimet e selisë së përherëshme nuk do të ndikohen nga aktiviteti i blerjeve për selinë qendrore, pra nuk mund të alokohen “fitime” nga aktiviteti i blerjeve sikurse nuk njihen as shpenzime (tek dega) që lidhen me këto blerje për selinë qendrore.

12.7. Paragrafi 6 qartëson faktin se një metodë për alokimin e fitimeve e përdorur një vit nuk duhet të ndryshohet në një vit tjetër thjesht për faktin se një metodë tjetër mund të japë rezultate më të favorshme në atë vit. Një nga qëllimet e marrëveshjeve tatimore është që t’i japë një sipërmarrje të një shteti kontraktues një siguri të caktuar lidhur me trajtimin tatimor që do t’i bëhet selisë së saj të përherëshme (degës) në shtetin tjetër kontraktues, si dhe sipërmarrjes (kompanisë) në vendin e vet, pra paragrafi jep siguri për një trajtim tatimor konsistent të vazhdueshëm.

12.8. Paragrafi 7 sanksionon faktin se dispozitat e neneve që trajtojnë lloje të veçanta të ardhurash kanë përparësi ndaj nenit 7. Kështu disa lloje të ardhurash si dividendët, interesat, honoraret, të ardhurat nga transporti ndërkombëtar, të ardhurat nga e artistëve dhe sportistëve etj., trajtohen në nene të veçanta të marrëveshjes dhe zbatohen dispozitat e këtyre neneve pavarësisht nga dispozitat e neneve 5 dhe 7.

### 13. Neni 8 “Transporti ndërkombëtar”

13.1. Ky nen trajton fitimet nga veprimtaria e anijeve dhe avionëve në trafikun ndërkombëtar.

13.2. Paragrafi 1 sanksionon faktin që e drejta e tatimit të fitimeve të realizuara nga veprimtaria e anijeve dhe avionëve në trafikun ndërkombëtar i takon shtetit kontraktues ku ndodhet vendi i drejtimit efektiv të sipërmarrjes (ku ndodhen zyrat qendrore të sipërmarrjes). Pra në rastin e transportit ndërkombëtar e drejta tatimore i jepet vetëm njerit shtet (ku ka menaxhimin efektiv, ku është rezidente kompania) pavarësisht nga ekzistenca e një selie të përherëshme në shtetin tjetër. Pra në bazë të këtij paragrafi kompanitë e huaja ajrore, p.sh. Alitalia, Olimpiku, Turkish Airlines, Malev për fitimet nga operimi i avionëve në aktivitetin e transportit ndërkombëtar me Shqipërinë tatohen respektivisht në Itali, Greqi, Turqi dhe Hungari pavarësisht nëse kanë degë (seli të përherëshme) në Shqipëri, ndërsa Albanian Airlines dhe Ada Air (që janë sipërmarrje që menaxhohen në Shqipëri–kompani rezidente shqiptare) tatohen në Shqipëri pavarësisht se mund të kenë degë në Itali, Greqi, Turqi, etj.

13.3. Vështirësi në interpretimin e të ardhurave nga transporti ndërkombëtar shpesh krijohen nga aktivitete të tjera që lidhen me transportin ndërkombëtar. Kështu shitja e biletave edhe për kompani të tjera (për linja të kombinuara), aktivitete reklame që lidhen me transportin ajror, shërbime tranziti (hoteleri, restorant brenda çmimit të biletës), transportimi i pasagjerëve për në aeroport, transportimi i mallrave në depo etj., konsiderohen aktivitete ndihmëse që janë pjesë apo lidhen direkt me transportin ndërkombëtar dhe trajtohen në bazë të dispozitave të paragrafit 1. Por nëse një shoqëri ajrore apo detare operon një hotel apo një restorant në një port, aeroport apo në qytet, që pjesërisht mund t’i shërbejë edhe transportit ndërkombëtar (pasagjerëve apo stafit të avionëve e anijeve), ky biznes nuk mund të konsiderohet pjesë e transportit ndërkombëtar dhe nuk mbulohet nga dispozitat e paragrafit 1, por nga nenet 5 dhe 7 (pra, hoteli ose restoranti konsiderohet një seli e përherëshme e kompanisë së huaj dhe fitimet që i atribuohen kësaj selie të përherëshme tatohen në vendin ku ndodhet kjo seli (pra në shembullin tonë ku ndodhet hoteli ose restoranti) dhe jo në vendin ku ka qendrën e menaxhimit shoqëria ajrore apo detare.

13.4. Në bazë të paragrafit 2 të këtij neni, në rastet kur vendi efektiv i menaxhimit të një biznesi të transportit ndërkombëtar mund të jetë në bordin e një anijeje, vendi i drejtimit efektiv konsiderohet shteti ku ndodhet porti i qëndrimit të përherëshëm të anijes, ose në mungesë të një porti të tillë, vendi ku është rezidente kompania apo individ i qëndrimit të anijen në trafikun ndërkombëtar.

13.5. Paragrafi 3 sanksionon faktin që dispozitat e paragrafit 1 zbatohen edhe ndaj grupimeve, marrëveshjeve apo bashkëpunimeve të formave të ndryshme që ekzistojnë në biznesin e transportit ndërkombëtar.

### 14. Neni 9 “Sipërmarrje të lidhura”

14.1. Ky nen trajton të drejtën e organeve tatimore të shteteve kontraktuese për të bërë rregullime dhe rikarakterizime të fitimeve për qëllime tatimore në rastet e transaksioneve midis palëve të lidhura, pra midis filialeve e mëmave apo midis kompanive nën të njëjtin kontroll, kur këto

transaksione nuk bazohen në parimin “arm’s length” pra përmbajnë “transferim çmimi” (transferim të fitimit nëpërmjet ndryshimit të çmimeve).

14.2. Paragrafi 1 sanksionon të drejtën e organit tatimor të njërit shtet kontraktues që të ndryshojë (rikarakterizojë) llogaritë e një sipërmarrjeje për efekt të llogaritjes së detyrimit tatimor, për transaksionet me palët e lidhura kur vlera e këtyre transaksioneve nuk përputhet me vlerat e tregut (pra transaksionet nuk janë të bazuara në parimin “arm’s length” dhe përmbajnë “transferim çmimi”). Metodat e rikarakterizimit bazohen kryesisht në parimin “arm’s length” dhe janë: metoda e çmimeve të krahasuara mes palëve të pavarura, metoda kosto plus, metoda çmimi i rishitjes minus, etj., të cilat trajtohen me hollësi në raportin e OECD-së “Udhëzime të transferimit të çmimeve për sipërmarrjet multinacionale dhe administratat tatimore”, të cilit i referohet edhe rregullorja jonë nr.2, datë 11.4.2000 “Për transferimin e çmimeve”.

14.3. Duhet pasur parasysh që korrektime mund të lidhen me të gjitha llojet e transaksioneve për furnizim mallrash e shërbimesh, por edhe me pagesa të interesave, honorareve të paguara për të drejtën e autorit, për të drejtën e përdorimit të patentave, pagesave për shërbime teknike etj. Dispozitat e këtij paragrafi nuk pengojnë administratën tatimore në aplikimin e dispozitave të legjislacionit të brendshëm lidhur me shpenzimet e lejuara dhe rikarakterizimet për efekt të luftimit të transferimit të çmimit. P.sh., në rastin tonë, njohja e shpenzimeve për interesa deri në nivelin e interesit të Bankës së Shqipërisë dhe deri në raportin 1 me 4 (1 mjete të veta dhe 4 të huazuara) dhe mosnjohja për efekt tatimi të shpenzimeve për interesa mbi këta kufij të paguar nga një filial shqiptar një kompanie të huaj.

14.4. Paragrafi 2 trajton faktin se rikarakterizimi i transaksioneve në bazë të paragrafit 1 mund të krijojë tatim të dyfishtë ekonomik, pra e njëjta pjesë e të ardhurave në duart e dy personave (mëmës dhe filialit apo dy filialeve të zotëruara nga i njëjti person) tatóhet dy herë: një herë në vendin ku u bë rregullimi (rikarakterizimi) në bazë të paragrafit 1 dhe një herë në vendin tjetër ku ajo e ardhur ka qenë tatuar në përputhje me vlerën e transaksioneve para rregullimit. Pra ky paragraf obligon shtetin tjetër të bëjë rregullimin korrespondues ose siç quhet shpesh rregullimin sekondar (nëse ai është dakord me të ardhurat e rikarakterizuara të personit të lidhur në shtetin e përmendur në fillim). P.sh. le të supozojmë se administrata jonë tatimore, në bazë të paragrafit 1, bën rikarakterizim të fitimeve të një filiali shqiptar për transaksione që ai ka me kompaninë mëmë në shtetin X, dhe në bazë të llogaritjeve të bazuara në parimin “arm’s length” i rrit fitimet e filialit me 100 000 \$ dhe i taton ato me 25%. Por, nga ana tjetër fitimet e kompanisë mëmë në shtetin X janë llogaritur me vlerat e transaksioneve të deklaruara nga kompania (para ri-karakterizimit në Shqipëri) dhe shuma prej 100 000 \$ ka qenë e përfshirë në të ardhurat e tatueshme të mëmës. Në këto kushte, paragrafi 2 obligon shtetin X të bëjë rregullimin korrespondues, pra uljen e fitimit të mëmës për 100.000 \$ në mënyrë që këto të ardhura të mos tatóhen dy herë. Sigurisht, kjo mund të krijojë probleme, pasi administrata tatimore e shtetit X mund të mos bjerë dakord me nivelin e fitimit të korrektuar nga administra tatimore shqiptare. Në këtë rast, për ta zgjidhur këtë problem, administratat tatimore bashkëpunojnë nëpërmjet procedurave të mirëkuptimit reciprok dhe shkëmbimit të informacionit (nenet 25 dhe 26 ).

#### 15. Neni 10 “Dividendët”.

15.1. Ky nen trajton tatimin e dividendëve, pra shpërndarjeve të fitimit nga shoqëritë aksionare e çfarëdo forme, tek personat që i zotërojnë aksionet (individë apo persona juridikë). Sigurisht që neni trajton dividendët që kompani rezidente të njërit shtet kontraktues i paguajnë rezidentëve të shtetit tjetër kontraktues. Siç do të trajtohet më me hollësi në vijim e drejta për tatimin e dividendëve nuk i takon ekskluzivisht asnjërit shtet kontraktues, pra as vendit të rezidencës (ku është rezident individi ose personi juridik që i përfiton dividendët) as vendit të burimit ku krijohen dividendët, pra ku është rezidente kompania që bën shpërndarjen e dividendëve. E drejta tatimore në këtë rast ndahet midis të dy shteteve kontraktuese.

15.2. Paragrafi 1 jep faktin se dividendët që paguhen nga një kompani rezidente e njërit shtet kontraktues një rezidenti të shtetit tjetër kontraktues do të tatóhen në këtë shtet tjetër, pra në shtetin ku është rezident përfituesi i dividendëve. Pra shohim që paragrafi trajton dividendët që paguhen nga një kompani që është rezidente e njërit shtet kontraktues një rezidenti (person fizik ose juridik) të shtetit tjetër kontraktues dhe nuk aplikohet ndaj dividendëve të paguar nga një kompani që është rezidente e një shteti të tretë.

15.3. Paragrafi 2 sanksionon të drejtën e tatimit të dividendëve nga vendi i burimit, pra nga shteti ku është rezidente kompania paguese e dividendëve. Sidoqoftë, kjo e drejtë kufizohet në një tarifë që bihet dakort midis shteteve kontraktuese (p.sh. 5% ose 10%) të shumës bruto të dividendit që

shpërndahet. Sqarimi "...nëse pronari përfitues i dividendëve është rezident i shtetit tjetër kontraktues ..." përjashton nga aplikimi i tarifës së reduktuar rastet kur dividendët merren nga një ndërmjetës, agent apo përfaqësues dhe pronari i vërtetë përfitues i dividendëve nuk është rezident i shtetit tjetër kontraktues. Paragrafi nuk jep detaje për mënyrën e tatimit dhe procedurat. Ato përcaktohen në legjislacionin e vendit ku krijohen dividendët. Në rastin tonë aplikohet tatimi në burim i dividendëve, por tarifa e tatimit në burim do të jetë sipas përcaktimeve të bëra në Marrëveshje. Paragrafi gjithashtu nuk jep procedurat se si vendi i rezidencës së përfituesit të dividendëve do të bëjë reduktimin e tatimit mbi dividendët të paguar në vendin e burimit. Kjo trajtohet në nenin 23 ku jepet metoda e eliminimi të tatimit të dyfishtë.

15.4. Paragrafi 3 jep përkufizimin e termit "dividentë" për efekt të aplikimit të Marrëveshjes, për të shmangur diferencat që ekzistojnë midis legjislacioneve të brendshme në karakterizimin e të ardhurave të ndryshme si dividendë. Ajo që ka rëndësi është dallimi i dividendit (që rrjedh nga aksione dhe merr pjesë në riskun e biznesit, me të drejtën e pjesëmarrjes në fitimet e kompanisë) nga kërkesat e borxhit, nga interesi (që rrjedh nga një hua, ka nivel fiks të ardhurave të rënë dakord paraprakisht, pavarësisht nga rezultati i kompanisë). Ky ndryshim ka rëndësi jo vetëm për trajtimin e ndryshëm tatimor që mund të kenë dividendët me interesat, por sidomos për faktin se interesi është shpenzim i lejuar për efekt tatimi, ndërsa dividendi jo.

15.5. Paragrafi 4 sanksionon faktin se kur kompania përfituese e dividendëve ka në shtetin tjetër kontraktues (ku krijohen dividendët) një seli të përhershme në kuptimin e nenit 5 lidhur me të cilën krijohen këto dividendë, apo në rastin e një individi ai ka në shtetin tjetër një bazë fikse lidhur me të cilën krijohen të ardhurat, atëherë aplikohen dispozitat e neneve 7 ose 14, sipas rastit, dhe jo ato të paragrafëve 1 dhe 2 të këtij neni.

15.6. Paragrafi 5 lidhet me raste shumë të komplikuar që kërkojnë interpretim të detajuar, sidoqoftë më konkretisht mund të shprehej: kur një kompani, rezidente e shtetit X, shpërndan dividendë që lidhen edhe me fitime të realizuara në Shqipëri, këto dividendë nuk mund të tatohen në Shqipëri, përveçse kur ato u paguhen personave rezidentë shqiptarë ose kur kompania paguese (rezidente e shtetit X) ka një seli të përhershme në Shqipëri dhe dividendët e paguar i atribuohen asaj selie të përhershme.

#### 16. Neni 11 Interesat

16.1. Ky nen jep trajtimin tatimor të interesave që lindin në njërin shtet kontraktues dhe i paguhen rezidentëve të shtetit tjetër kontraktues. Edhe në këtë rast, e drejta tatimore ndahet midis të dy shteteve.

16.2. Paragrafi 1 sanksionon të drejtën e tatimit të interesave në shtetin ku është rezident përfituesi i interesave, por kjo e drejtë nuk është ekskluzive.

16.3. Paragrafi 2 jep të drejtën e kufizuar deri në një përqindje të caktuar të tatimit të interesave nga vendi i burimit, ku lindin interesat (shteti ku është rezidente kompania ose banka që paguan interesat).

16.4. Në disa marrëveshje (paragrafi i marrëveshjes shtetin X) shtetet bien dakord për përjashtimin nga tatimi të interesave nga huatë qeveritare (të marra ose të paguara nga qeveria e njërit shtet kontraktues) apo që rrjedhin nga marrëveshje të posaçme qeveritare midis dy vendeve.

16.5. Paragrafi 4 jep përkufizimin e termit interesa, që janë të ardhura nga huatë, pa të drejtën e pjesëmarrjes në fitimet e debitorit. (Pra mospjesëmarrja në riskun e biznesit dhe në fitime dhe përqindja fikse e interesit janë elemente të rëndësishme që e dallojnë atë nga dividendi). Pravarësisht nga emërtime të ndryshme që mund të shfaqen në instrumenta të ndryshme financiare duhet që interesi të përmbajë tre elementet e sipërpërmendura që të karakterizohet si interes dhe (ajo që ka më shumë rëndësi) të njihet si shpenzim i lejuar për efekt të llogaritjes së tatimit mbi fitimin. Përndryshe pagesa mund të konsiderohet dividend ose pjesëmarrje në fitime dhe të mos njihet si shpenzim i lejuar dhe të përfshihet fitimin e tatueshëm.

16.6. Paragrafi 5: neni 11 nuk zbatohet ndaj interesave efektivisht të lidhura me një seli të përhershme në vendin e burimit, pasi në një rast të tillë do të aplikohet neni 7 (të ardhurat e selisë së përhershme do të tatohen në vendin e burimit).

16.7 Paragrafi 6: rregulli i burimit për interesat (rasti është i ngjashëm me paragrafin 5 tek dividendët). Interesat konsiderohen me burim në Shqipëri kur pagesa është një kompani shqiptare, megjithatë, nëse një kompani rezidente e shtetit X paguan intersa për një hua të përdorur për biznesin e

një selie të përhershme që kjo kompani ka në Shqipëri dhe interesat krijohen nga kjo seli e përhershme, atëherë burimi i interesave është vendi ku ndodhet selia e përhershme, pra në këtë rast Shqipëria.

16.8. Paragrafi 7 trajton rastet kur ka “transferim çmimi” në pagesat e interesave midis palëve të lidhura dhe sanksionon faktin se vetëm pagesat normale (të bazuara në parimin “arms length”) përfitojnë nga dispozitat e këtij neni, pra aplikimin e tarifës së reduktuar.

#### 17. Neni 12 Honoraret

17.1. Ky nen trajton trajtimin tatimor të “honorareve” ose të ardhurave nga e drejta e autorit, që janë të ardhurat nga dhënia e së drejtës së përdorimit të “pasurisë intelektuale” apo pasurive të patrupëzuara si vepra letrare, artistike, licensa, patenta, marka tregtare, programe kompjuterike etj., sigurisht rastet kur pronari i pasurisë së patrupëzuar që përfiton honoraret është rezident i njërit shtet dhe përdoruesi (burimi ku krijohen honoraret) është në shtetin tjetër kontraktues.

17.2. Paragrafi 1 jep të drejtën e tatimit të honorarëve në vendin ku është rezident përfituesi i tyre, por kjo e drejtë nuk është ekskluzive.

17.3. Paragrafi 2 jep të drejtën e kufizuar deri në një përqindje të caktuar të tatimit të honorarëve nga vendi i burimit, ku lindin honorarët (ku është rezident përdoruesi i së drejtës së autorit apo patentës).

17.4. Paragrafi 3 bën përcaktimin e termit “honorare” si pagesa për përdorimin apo të drejtën e përdorimit të së drejtës së autorit, mbi punime letrare, shkencore, artistike, patenta, marka tregtare, formula kimike, procese teknologjike, programe kompjuterike etj.

17.5. Paragrafët 4 – 6 janë analoge me paragrafët 5-7 të nenit 11, pra trajtimi është i njëjtë, veçse në vend të interesave kemi honorarët.

#### 18. Neni 13 Fitimet nga kapitali

18.1. Ky nen trajton fitimet nga shitja e kapitalit.

18.2. Paragrafi 1 përcakton të drejtën e vendit të burimit (ku ndodhen pasuritë e paluajtshme) të tatohet fitimet nga shitja e pasurive të paluajtshme, duke mbuluar edhe fitimet nga shitja e pasurive të paluajtshme dhe asetëve të biznesit.

18.3. Paragrafi 2 trajton pasuritë e luajtshme që bëjnë pjesë në pasuritë biznesore të një selie të përhershme që një sipërmarrje e njërit shtet kontraktues ka në shtetin tjetër, apo pasuritë e luajtshme (biznesore) të një baze fikse që një person fizik i njërit shtet ka në shtetin tjetër. Fitimet nga shitja e këtyre pasurive tatohen në shtetin ku ndodhet selia e përhershme apo baza fikse.

18.4. Paragrafi 3 trajton fitimet nga shitja e anijeve dhe avionëve që operojnë në trafikun ndërkombëtar, të cilat tatohen në shtetin ku ka menaxhimin efektiv ose ku është rezidente kompania që i operon këto anije ose avionë.

18.5. Paragrafi 4 sanksionon të drejtën ekskluzive të vendit të rezidencës për tatimin e fitimeve nga shitja e çdo pasurie, të ndryshme nga ato të referuara në paragrafët 1 – 3.

#### 19. Neni 14 Shërbimet personale të pavarura

19.1. Ky nen trajton të ardhurat nga aktivitetet profesionale të pavarura të avokatëve, inxhinierëve, pedagogëve, mjekëve, dentistëve, arkitektëve, ekspertëve kontabël etj. Në princip trajtimi tatimor është i njëjtë me nenin 7, vetëm se në nenin 7 trajtohen kompanitë (personat juridikë), ndërsa në nenin 14 personat fizikë. Kuptimi i selisë së përhershme i përdorur në nent 5 dhe 7, në rastin e personave fizikë zëvendësohet me termat “bazë fikse” nëpërmjet së cilës personi fizik (rezident i njërit shtet) ushtron biznes në shtetin tjetër kontraktues.

19.2. Paragrafi 1 sanksionon të drejtën e shtetit të residences për të tatuar të ardhurat e personit fizik, përveç rastit kur ky person ka një bazë fikse në shtetin tjetër (vandin e burimit, ku krijohen të ardhurat). Në një rast të tillë, pra kur personi fizik ka një bazë fikse për ushtrimin e biznesit të tij në shtetin tjetër, atëherë të ardhurat që i atribuohen kësaj baze fikse tatohen në këtë shtet tjetër (pra në vandin e burimit). Siç shihet llogjika është e njëjtë me nenin 7, madje në modelet e fundit të OECD-së nenet 7 dhe 14 janë bashkuar, duke unifikuar edhe konceptin e “selisë së përhershme” me atë të “bazës fikse”.

19.3. Paragrafi 2 bën përkufizimin e “shërbimeve profesionale”, ku siç u përmend më sipër përfshihen të gjitha shërbimet e pavarura të ofruara nga personat fizikë (pra që ushtrojnë biznes të pavarur dhe tatohen si të tillë, pra nuk janë të punësuar), siç janë aktivitetet e artistëve, trajnerëve, të mësimdhënies, të avokatëve, konsulentëve, mjekëve, dentistëve, arkitektëve, etj.

## 20. Neni 15 Shërbimet personale të varura (të ardhurat nga punësimi)

20.1. Paragrafi 1 sanksionon faktin se të ardhurat nga punësimi tatohen në vendin e burimit, ku ushtrohet puna.

20.2. Paragrafi 2, jep një përjashtim nga rregulli i përgjithshëm i paragrafit 1, pra e drejta tatimore i lihet vendit të residences së individit dhe jo vendit ku ushtrohet puna, por vetëm nëse plotësohen të trija kushtet e dhëna në këtë paragraf, që janë:

a) individ është present në vendin e burimit (ku ushtrohet puna) për një periudhë ose periudha që në total nuk i kalojnë 183 ditë, për çdo periudhë 12-mujore që fillon ose përfundon në vitin kalendarik përkatës;

b) punëdhënësi (personi që kryen pagesën) nuk është rezident i vendit të burimit (pra pagesa bëhet nga një punëdhënësi që nuk është rezident i shtetit ku ushtrohet puna);

c) pagesa nuk bëhet nga një seli e përhershme e punëdhënësit në vendin e burimit.

20.3. Paragrafi 3 sanksionon një përjashtim nga paragrafët 1 dhe 2, lidhur me të ardhurat nga punësimi në anije apo avionë që operojnë në trafikun ndërkombëtar, të cilat tatohen në shtetin ku ka drejtimin efektiv ose është rezident sipërmarrja që operon anijet ose avionët.

## 21. Neni 16 Shpërblimet e drejtorëve

Shpërblimet e drejtorëve dhe pagesa të ngjashme, ku përfshihen të ardhurat e realizuara nga të qenit anëtar i bordit drejtues, apo këshillave drejtuese në një kompani apo ent tjetër, tatohen vetëm në shtetin kontraktues ku është rezident kompania që paguan këto shpërblime (pavarësisht nga rezidenca e individit përfitues). P.sh. Një individ, rezident i shtetit X, është anëtar i bordit drejtues të një kompanie rezidente shqiptare dhe vjen në Shqipëri rreth 10 herë në vit, duke qëndruar mesatarisht 2-3 ditë për çdo herë, për të marrë pjesë në mbledhjet e bordit drejtues të kompanisë. Në bazë të kontratës që ka me kompaninë ai merr një shpërblim prej 2 000 USD në muaj ose 2000 USD për çdo mbledhje. Pavarësisht nga forma e pagesës, këto pagesa tatohen vetëm në shtetin ku është rezident kompania, pra, në këtë rast, në Shqipëri.

## 22. Neni 17 Artistët dhe sportistët

22.1. Paragrafi 1 sanksionon faktin se të ardhurat e artistëve apo sportistëve, të cilët janë rezidentë të njërit shtet kontraktues, të realizuara nga aktivitetet artistike apo sportive në shtetin tjetër kontraktues, do të tatohen në këtë shtet tjetër (pra aty ku ushtrohet aktiviteti). P.sh. nëse një këngëtar, rezident i shtetit X, jep një koncert në Shqipëri, të ardhurat e realizuara do të tatohen në Shqipëri, pavarësisht se individ është rezident grek.

22.2. Paragrafi 2 sanksionon faktin se kur të ardhurat nga një aktivitet artistik apo sportiv nuk i kalojnë direkt artistit apo sportistit, por një personi juridik jo rezident, përsëri, pavarësisht nga dispozitat e neneve 7 dhe 14, këto të ardhura do të tatohen në vendin ku është ushtruar aktiviteti i artistit apo sportistit. P.sh. në shembullin e mësipërm nëse këngëtari figuron si i punësuar i një kompanie të shtetit X apo një shteti të tretë dhe kjo kompani figuron si kontraktuese me një ent shqiptar për organizimin e koncertit, dhe të ardhurat që i paguhen kësaj kompanie lidhur me koncertin e dhënë në Shqipëri, do të tatohen në Shqipëri, (pavarësisht se kompania nuk ka një seli të përhershme në Shqipëri në kuptimin e nenit 7).

22.3. Në disa raste shtetet kontraktuese bien dakord për përfshirjen e një paragrafi të tretë, nëpërmjet të cilit, me synim rritjen e shkëmbimeve kulturore e artistike, përjashtojnë nga tatimi aktivitetet artistike apo sportive të organizuara në kuadrin e bashkëpunimeve bilaterale të organeve të qeverisjes qendrore apo vendore.

## 23. Neni 18 Pensionet

E drejta ekskluzive tatimore i takon vendit të rezidencës së përfituesit të pensionit. P.sh. nëse një individ rezident shqiptar merr pension nga punësimi i tij në të kaluarën në shtetin X, të ardhurat nga pensioni tatohen vetëm në Shqipëri. Sigurisht, Shqipëria nuk mund të aplikojë tatim nëse nuk ka një dispozitë për tatimin e të ardhurave nga pensionet në legjislacionin e saj të brendshëm.

## 24. Neni 19 Shërbimet qeveritare

24.1. Ky nen zbatohet ndaj pagave dhe shpërblimeve të tjera të ngjashme, si dhe pensioneve lidhur me shërbimet qeveritare. Ky nen mbulon të ardhurat që punonjës (zakonisht zyrtarë apo nëpunës) të njërit shtet kontraktues, të emëruar apo të caktuar për afate të ndryshme kohe, të punojnë në shtetin tjetër kontraktues.

24.2. Nënparagrafi a i paragrafit 1 sanksionon faktin se pagat dhe shpërblime të tjera të

ngjashme që u paguhen personave që punojnë për shtetin shqiptar, në territorin e shtetit X (p.sh. si punonjës ambassade ose punonjës në institucione të tjera që përfaqësojnë Shqipërinë në shtetin X), do të taten vetëm në Shqipëri, pavarësisht nga koha e qëndrimit në shtetin X.

24.3. Nënparagrafi b i paragrafit 1, bën përjashtim nga rregulli i përgjithshëm i dhënë në nënparagrafin a, dhe jep të drejtën tatimore vetëm shtetit X, kur individ (edhe pse punon për shtetin shqiptar në shtetin X) është nënshkruar i shtetit X ose nuk u bë rezident i shtetit X vetëm për qëllim të këtij punësimi (shërbimi).

24.4. Paragrafi 2 trajton pensionet që rrjedhin nga shërbimet qeveritare në të kaluarën. Nënparagrafi a parimin e përgjithshëm se këto pensione do të taten në shtetin dërgues, i cili ka paguar pagën dhe sigurimet shoqërore (pra për punonjësit që kanë punuar për Shqipërinë në shtetin X). Nënparagrafi b bën një përjashtim nga ky rregull, duke ia dhënë të drejtën tatimore shtetit X, nëse individ është rezident dhe nënshkruar i shtetit X.

25. Neni 20 Studentët, pedagogët dhe kërkuesit shkencorë

25.1. Në paragrafin 1 sanksionohet parimi që bursat apo të ardhurat e përfituara nga studentët apo specialistët që ndodhen për qëllime studimi apo trajnimi në një shtet kontraktues, përjashtohen nga tatimi në këtë shtet, me kusht që këto të ardhura të vijnë nga burime jashtë këtij shteti. Pra studentët shqiptarë përjashtohen nga tatimi në shtetin X, me kusht që të ardhurat e tyre të vijnë nga burime jashtë shtetit X.

25.2. Nëpërmjet paragrafit 2, palët kontraktuese bien dakord që edhe të ardhurat që studentët mund të sigurojnë nga punësimi në shtetin kontraktues ku studiojnë, të përjashtohen nga tatimi (zakonisht deri në një kufi të caktuar) ose të gëzojnë të njëjtat përjashtime dhe lehtësi si studentët vendas. Pra nëse studentë shqiptarë, gjatë viteve të studimit, punësohen në shtetin X ato gëzojnë të njëjtat përjashtime dhe lehtësi si studentët e shtetit X.

25.3. Paragrafi 3 (në disa marrëveshje edhe ky mund të jetë nen i veçantë) ofron një trajtim të veçantë për të ardhurat që pedagogët apo kërkuesit shkencorë, rezidentë të njërit shtet, realizojnë nga mësimdhënia apo kërkimet shkencore në shtetin tjetër.

26. Neni 21 Të ardhura të tjera

Ky nen përfshin të ardhura që nuk mbulohen në asnjë nga nenet e tjera të marrëveshjes, për të cilat të drejtën e tatimit e ka shteti ku është rezident përfituesi i të ardhurave, me përjashtim të rasteve kur përfituesi ka në shtetin tjetër kontraktues një seli të përhershme apo një bazë fikse, dhe të ardhurat në fjalë i atribuohen asaj selie të përhershme apo baze fikse. Në një rast të tillë zbatohen dispozitat e nenit 7 (për personat juridikë) dhe të nenit 14 (për personat fizikë).

27. Neni 22 Kapitali

27.1. Ky nen trajton tatimin e kapitalit (jo të fitimeve nga shitja e kapitalit, pasi ato trajtohen në nenin 13), në rastin tonë tatimin mbi pasurinë, që në shumë vende zakonisht aplikohet ndaj vlerës së kapitalit (përfshirë pasuritë individuale apo biznesore).

27.2. Paragrafi 1 sanksionon parimin se kapitali i përfaqësuar nga pasuri të paluajtshme, që një rezident i një shteti kontraktues ka në shtetin tjetër kontraktues, do të taten në shtetin ku ndodhen pasuritë e paluajtshme.

27.3. Paragrafi 2 sanksionon faktin që kapitali i përfaqësuar nga pasuri të luajtshme që janë pjesë e pasurive biznesore të një selie të përhershme, që një kompani rezidente e njërit shtet ka në shtetin tjetër dhe kapitali i përfaqësuar nga pasuri të luajtshme që një person fizik rezident i njërit shtet ka në shtetin tjetër, do të taten në shtetin ku ndodhet selia e përhershme apo baza fikse.

27.4. Paragrafi 3 sanksionon faktin që kapitali i përfaqësuar nga anije apo avionë që operojnë në transportin ndërkombëtar do të taten në shtetin kontraktues ku ndodhet vendi i drejtimit efektiv ose ku është rezidente kompania që operon këto anije apo avionë.

28. Neni 23 Eliminimi i tatimit të dyfishtë

28.1. Ky nen trajton metodat për eliminimin e tatimit të dyfishtë, pra rastet, kur një person fizik apo juridik, rezident i njërit shtet kontraktues (vendi i rezidencës së tatimpaguesit), realizon të ardhura nga burime në shtetin tjetër kontraktues (vendi i burimit të të ardhurave), dhe këto të ardhura, në përputhje me dispozitat e marrëveshjes, janë tatuar në këtë shtet tjetër, atëherë shteti i përmendur në fillim (shteti i rezidencës) duhet të eliminojë tatimin e dyfishtë duke i përjashtuar ato të ardhura nga tatimi ose duke i kredituar subjektit tatimin e paguar në shtetin tjetër. Pra për eliminimin e tatimit të dyfishtë përdoren dy metoda:

28.2. Metoda e përjashtimit: Sipas parimit të përjashtimit shteti i rezidencës nuk taton të

ardhurat të cilat në bazë të dispozitave të marrëveshjes taten në shtetin e burimit. Parimi i përjashtimit përmban në vetvete dy metoda: a) “përjashtim të plotë” të ardhurat që mund të taten në shtetin e burimit nuk përfshihen fare në bazën tatimore në shtetin e rezidencës dhe b) “përjashtim progresiv”: të ardhurat që mund të taten në vendin e burimit nuk taten në shtetin e rezidencës, por ky i fundit mban të drejtën t’i marrë në konsideratë ato të ardhura kur përcakton tarifën (progresive) të tatimit për pjesën e mbetur të të ardhurave.

28.3. Metoda e kreditimit: Në bazë të parimit të kreditimit, shteti i rezidencës llogarit tatimin në bazë të të ardhurave globale të tatimpaguesit, përfshirë të ardhurat nga shteti i burimit, të cilat sipas marrëveshjes mund të jenë tatuar në shtetin tjetër dhe më pas lejon kreditimin (reduktimin) e tatimit të paguar në vendin e burimit. Parimi i kreditimit gjithashtu përmban dy metoda: a) “kreditim i plotë” kur shteti i rezidencës lejon kreditimin e shumës totale të tatimit që mund të jetë paguar në shtetin tjetër dhe b) “kreditim i zakonshëm” kur shteti i rezidencës lejon kreditimin e tatimit të paguar në shtetin tjetër deri në masën e tatimit të vet për të ardhurat e realizuara në shtetin tjetër.

Zakonisht në marrëveshjet që ne kemi përfunduar është preferuar metoda e kreditimit të zakonshëm, ndërsa nga vendet e tjera, sipas rastit, është përdorur metoda e përjashtimit ose metoda e kreditimit, ose në disa raste kombinimi i të dyjave (për disa lloje të ardhurash përjashtimi, për të tjera, kreditimi).

#### 29. Neni 24 Mosdiskriminimi

29.1. Paragrafi 1 sanksionon parimin se për qëllime tatimore nuk lejohet diskriminimi mbi baza nacionaliteti. Pra nënshtetasit e një shteti kontraktues që ushtrojnë biznes në shtetin tjetër kontraktues nuk duhet të gëzojnë një trajtim tatimor më pak të favorshëm se nënshtetasit e shtetit të përmendur në fund.

29.2. Paragrafi 2 sanksionon parimin që të ardhurat që një sipërmarrje e një shteti kontraktues realizon në shtetin tjetër kontraktues, nëpërmjet një selie të përhershme të ndodhur në këtë shtet tjetër, do të gëzojnë një trajtim tatimor të barabartë me sipërmarrjet vendase që kryejnë aktivitete të njëjta ose të ngjashme.

29.3. Paragrafi 3 garanton trajtim të barabartë tatimor lidhur me njohjen si shpenzime të lejuara për efekt tatimi të interesave, honorareve apo pagesave të tjera.

29.4. Paragrafi 4 sanksionon trajtim tatimor jo diskriminues për kompanitë e zotëruara apo të kontrolluara nga rezidentë të shtetit tjetër.

#### 30. Neni 25 Procedura e mirëkuptimit reciprok

30.1. Paragrafi 1 i jep të drejtë tatipaguesit të apelojë tek autoritetet tatimore të vendit të rezidencës kur mendon se është trajtuar në kundërshtim me dispozitat e marrëveshjes tatimore.

30.2. Paragrafi 2 trajton faktin që autoriteti kompetent që merr ankesën, kur e shikon të drejtë atë, përpiqet që në bashkëpunim me autoritetin kompetent të shtetit tjetër ta zgjidhin çështjen me mirëkuptim reciprok.

30.3. Paragrafi 3 i jep të drejtë autoriteteve kompetente të shteteve kontraktuese që të përpiqen që me mirëkuptim reciprok, të zgjidhin konfliktet që lidhen me interpretimin dhe aplikimin e dispozitave të marrëveshjes.

30.4. Paragrafi 4 i lejon autoritetet kompetente të organizojnë takime direkte apo të krijojnë komisione të përbashkëta për zgjidhjen e problemeve dhe arritjen e mirëkuptimit.

#### 31. Neni 26 Shkëmbimi i informacionit

31.1. Ky nen trajton nevojën e shkëmbimit të informacioneve ndërmjet autoriteteve kompetente të shteteve kontraktuese për të ndihmuar reciprokisht njëri-tjetrin për zbatimin e dispozitave të marrëveshjes.

31.2. Paragrafi 1 sanksionon detyrimin e organeve tatimore për të shkëmbyer informacione të nevojshme për zbatimin e dispozitave të marrëveshjes. Në shumë marrëveshje palët bien dakord të shkëmbejnë informacione edhe për persona që nuk mbulohen nga neni 1, si dhe për tatime që nuk mbulohen nga neni 2 i marrëveshjes. Paragrafi gjithashtu sanksionon detyrimin për përdorimin konfidencial dhe ruajtjen e sekretit të këtyre informacioneve, njëllë siç veprohet me informacionet e brendshme, në përputhje me dispozitat e legjislacionit të brendshëm.

31.3. Paragrafi 2 sanksionon faktin se shtetet kontraktuese nuk janë të detyruara të japin informacione që bien në kundërshtim me legjislacionin e tyre të brendshëm.

#### 32. Neni 27 Diplomatat

Ky nen sanksionon faktin se dispozitat e marrëveshjes tatimore nuk cenojnë privilegjet fiskale

që u jepen diplomatëve nga e drejta ndërkombëtare apo marrëveshje ndërkombëtare të posaçme (Konventa e Vjenës).

33. Neni 28 Hyrja në fuqi

Ky nen sanksionon faktin që marrëveshja duhet të ratifikohet nga parlamentet e shteteve kontraktuese dhe dispozitat e saj kanë efekt nga 1 janari i vitit që pason vitin e shkëmbimit e instrumenteve të ratifikimit ose të njoftimit reciprok për përmbushjen e procedurave të hyrjes në fuqi në secilin shtet kontraktues.

34. Neni 29 Përfundimi

Ky nen sanksionon faktin që marrëveshja mund të pushojë së zbatuari, pra mund të denoncohet nga secili shtet kontraktues, por ky denoncim zakonisht mund të bëhet jo më vonë se 6 muaj para përfundimit të vitit kalendarik dhe marrëveshja do të pushojë së zbatuari nga 1 janari i vitit që pason vitin në të cilin është bërë denoncimi.

Bashkëngjitur janë: modeli i vërtetimit të rezidencës për subjektet shqiptare, formulari i aplikimit të marrëveshjes tatimore, lista e marrëveshjeve tatimore të përfunduara nga vendi ynë deri në fund të vitit 2003, si dhe një model i marrëveshjes tatimore.

MINISTRI I FINANCAVE

**Arben Malaj**



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E FINANCAVE  
DREJTORIA E PËRGJITHSHME  
E TATIMEVE

REPUBLIC OF ALBANIA  
MINISTRY OF FINANCE  
GENERAL TAXATION  
DEPARTMENT

Rr. "Mustafa Lleshi", Nr. 7, Tirana Tel : (355 4) 374156 Fax: (355 4) 374159

Nr. \_\_\_\_ Prot.

Tiranë, \_\_ / \_\_ /2004

Kopja e parë për Autoritetet Tatimore të Huaja  
1st copy for the Foreign Tax Authority

**ÇERTIFIKATE REZIDENCE  
RESIDENCE CERTIFICATE**

Unë vërtetoj se:

Emri:

Adresa:

Forma Juridike

NIPT:

Kodi fiskal :

Zyra e Tatimeve:

për vitin kalendarik 2004 është Rezident i Republikës së Shqipërisë në kuptim të Konventës për Shmangjen e Tatimeve të Dyfishta të nënshkruar midis Republikës së Shqipërisë dhe Republikës së \_\_\_\_\_.

I do certify that:

Name:

Address:

Legal Form:

Tax ID :

Fiscal code :

Tax Office :

is a Resident of the Republic of Albania during the calendar year 2004 within the meaning of the Convention for the avoidance of double taxation concluded between the Republic of Albania and the \_\_\_\_\_ Republic.

**AUTORITETI KOMPETENT  
COMPETENT AUTHORITY**

**DREJTORI I PERGJITHSHEM I TATIMEVE**

REPUBLIKA E SHQIPERISE  
MINISTRIA E FINANCAVE  
DREJTORIA E PERGJITHSHME  
E TATIMEVE

REPUBLIC OF ALBANIA  
MINISTRY OF FINANCE  
GENERAL TAXATION  
DEPARTMENT

Rr. "Mustafa Lleshi", Nr. 7, Tirana Tel : (355 4) 374156 Fax: (355 4) 374159

Nr. \_\_\_\_ Prot.

Tiranë, \_\_/\_\_/2004

Kopja e dytë për Tatimpaguesin  
2nd copy for the Taxpayer

**ÇERTIFIKATE REZIDENCE  
RESIDENCE CERTIFICATE**

Unë vërtetoj se:

Emri:

Adresa:

Forma Juridike:

NIPT:

Kodi fiskal :

Zyra e Tatimeve:

për vitin kalendarik 2004 është Rezident i Republikës së Shqipërisë në kuptim të Konventës për Shmangjen e Tatimeve të Dyfishta të nënshkruar midis Republikës së Shqipërisë dhe Republikës së Greqisë.

I do certify that:

Name:

Address:

Legal Form:

Tax ID :

Fiscal code :

Tax Office :

is a Resident of the Republic of Albania during the calendar year 2004 within the meaning of the Convention for the avoidance of double taxation concluded between the Republic of Albania and the Hellenic Republic.

**AUTORITETI KOMPETENT  
COMPETENT AUTHORITY**

**DREJTORI I PERGJITHSHEM I TATIMEVE**

REPUBLIKA E SHQIPERISE  
MINISTRIA E FINANCAVE

REPUBLIC OF ALBANIA  
MINISTRY OF FINANCE

DREJTORIA E PERGJITHSHME  
E TATIMEVE

GENERAL TAXATION  
DEPARTMENT

Rr. "Mustafa Lleshi", Nr. 7, Tirana Tel : (355 4) 374156 Fax: (355 4) 374159

Nr. \_\_\_\_ Prot.

Tiranë, \_\_ / \_\_ /2004

Kopja e tretë për Autoritetet Tatimore Shqiptare  
3d copy for the Albanian Tax Authority

**ÇERTIFIKATE REZIDENCE  
RESIDENCE CERTIFICATE**

Unë vërtetoj se:

Emri:

Adresa:

Forma Juridike:

NIPT:

Kodi fiskal :

Zyra e Tatimeve:

për vitin kalendarik 2003 është Rezident i Republikës së Shqipërisë në kuptim të Konventës për Shmangjen e Tatimeve të Dyfishta të nënshkruar midis Republikës së Shqipërisë dhe Republikës së \_\_\_\_\_.

I do certify that:

Name:

Address:

Legal Form:

Tax ID :

Fiscal code :

Tax Office :

is a Resident of the Republic of Albania during the calendar year 2004 within the meaning of the Convention for the avoidance of double taxation concluded between the Republic of Albania and the \_\_\_\_\_ Republic.

AUTORITETI KOMPETENT  
COMPETENT AUTHORITY

DREJTORI I PERGJITHSHEM I TATIMEVE

REPUBLIKA E SHQIPERISE  
MINISTRIA E FINANCAVE  
DREJTORIA E PERGJITHSHME  
E TATIMEVE

REPUBLIC OF ALBANIA  
MINISTRY OF FINANCE  
GENERAL TAXATION  
DEPARTMENT

Rr. "Mustafa Lleshi", Nr. 7, Tirana Tel : (355 4) 374156 Fax: (355 4) 374159

Nr. \_\_\_\_ Prot.

Tiranë, \_\_ / \_\_ /2004

Kopjo 1 për kërkuesin (përfituesin e të ardhurave) – Copy 1 for the claimant (recipient of income)

KERKESE PER ZBATIMIN E MARREVESHJES PER HEQJEN E TAKSIMIT TE DYFISHTE  
MIDIS SHQIPERISE DHE .....

CLAIM FOR THE APPLICATION OF THE AGREEMENT FOR THE AVOIDANCE OF DOUBLE  
TAXATION BETWEEN ALBANIA AND .....

I. Të dhëna për përfituesin e të ardhurave – Information on the recipient of income:

Emri i plotë/Emri tregtar  
Full name/Business name .....  
Forma juridike  
Legal form .....  
Profesioni/aktiviteti  
Profession/activity.....  
Kodi fiskal ose NIPT  
Fiscal code or TIN .....  
Adresa e plotë  
Full address .....  
Përfaqsimi në Shqipëri (nëse ka)  
Representation in Albania (if any) .....

II. Të dhëna për paguesin e të ardhurave – Information on the payer of income:

Emri i plotë/Emri tregtar  
Full name/Business name .....  
Forma juridike  
Legal form .....  
Profesioni/aktiviteti  
Profession/activity .....  
Kodi fiskal ose NIPT  
Fiscal code or TIN .....  
Adresa e plotë  
Full Address .....

III. Të dhëna mbi të ardhurat – Information on income:

Lloji i të ardhurës  
Type of income .....

Shuma e të ardhurës  
Total amount of income .....

Data e pagesës  
Date of payment .....  
Tarifa e tatimit dhe shuma e tatimit të paguar  
Tax rate and amount of tax paid .....

IV. Të dhëna për dokumentat që bashkangjiten – Information on attached documents:  
(lloji i dokumentave, numri dhe data e lëshimit – type of documents, number and issuing date)

.....  
.....  
.....

.....  
.....  
.....

V. Të dhëna të tjera – Other information:

.....  
.....  
.....  
.....  
.....

VI. Deklarimi i kërkuesit (përfituesit) – Declaration of the claimant (beneficiary):

Unë deklaroj se jam pronari përfitues i të ardhurave të sipër-përmendura dhe se çdo e dhënë në këtë kërkesë është e vërtetë – I hereby declare that I am the beneficial owner of the above-mentioned income and any information given in this claim is true.

Vendi dhe data – Place and date                      Firma dhe vula e përfituesit – Signature and Stamp of the beneficiary

.....

VII. Vërtetimi nga Autoriteti Tatimor i Vendlindjes së Rezidencës së përfituesit – Certification by the Tax Authority of the beneficiary's residence country.

Unë vërtetoj se përfituesi ka qenë/është rezident i ..... gjatë vitit të specifikuar më sipër në kuptimin e Marrëveshjes për heqjen e taksimit të dyfishtë midis Shqipërisë dhe .....  
I certify that the beneficiary is/was during the year specified above a resident of ..... within the meaning of the Agreement for the avoidance of double taxation between Albania and .....

Vendi dhe data                      Vula e Autoritetit Tatimor                      Emri dhe nënshkrimi i punonjësit kompetent

Place and date                      Stamp of Tax Authority                      Name and Signature of competent official

.....

## UDHËZIME PËR PLOTESIMIN E KËTIJ FORMULARI

1. Ky formular u jepet personave rezidentë të vendeve me të cilat Republika e Shqipërisë ka përfunduar marrëveshje për heqjen e taksimit të dyfishtë, ndaj të cilëve aplikohen dispozitat e këtyre marrëveshjeve lidhur me tatimet e mbajtura në burim ndaj dividendëve, interesave, honorarëve dhe shërbimeve teknike.

2. Formulari konsiston në katër kopjo, kopjo 1 për përfituesin, kopjo 2 për paguesin e të ardhurave, kopjo 3 për Autoritetin Tatimor Shqiptar dhe kopjo 4 për Autoritetin e Huaj Tatimor. Rubrikat I, IV, V dhe VI plotësohen nga përfituesi (kërkuesi); rubrikat II dhe III nga paguesi dhe rubrika VII nga Autoriteti i Huaj Tatimor.

3. Aplikimi i plotësuar paraqitet në Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve në Republikën e Shqipërisë në adresën: Rr."Mustafa Lleshi", nr.7, Tiranë, Shqipëri, jo më vonë se dy vjet nga data e kryerjes së pagesës.

## INSTRUCTIONS FOR FILLING IN THIS FORM

1. This form is submitted to resident persons of countries with which the Republic of Albania has concluded Agreements for the avoidance of double taxation and which persons are subject to the provisions of such Agreements concerning the withholding taxes on dividends, interest, royalties and technical services.

2. The form consists in four copies; copy 1 is for the beneficiary, copy 2 for the payer of income (remuneration), copy 3 for the Albanian Tax Authority and copy 4 for the Foreign Tax Authority. Items I, IV, V and VI are to be filled by the beneficiary (claimant); items II and III are to be filled by the payer and item VII is to be filled by the foreign tax authority.

3. The completed form is submitted to the General Taxation Department in the Republic of Albania at the address: Rr."Mustafa Lleshi" nr.7, Tirana, Albania, within the period of two years from the date of the payment.

DREJTORIA E PERGJITHSHME  
E TATIMEVE

GENERAL TAXATION  
DEPARTMENT

Rr. "Mustafa Lleshi", Nr. 7, Tirana Tel : (355 4) 374156 Fax: (355 4) 374159

Nr. \_\_\_\_ Prot.

Tiranë, \_\_/\_\_/2004

Kopjo 2 për paguesin e të ardhurave (shpërblimit) – Copy 2 for the payer of income(remuneration)

KËRKESË PËR ZBATIMIN E MARRËVESHJES PËR HEQJEN E TAKSIMIT TË DYFISHTË  
MIDIS SHQIPËRISË DHE .....

CLAIM FOR THE APPLICATION OF THE AGREEMENT FOR THE AVOIDANCE OF DOUBLE  
TAXATION BETWEEN ALBANIA AND .....

I. Të dhëna për përfituesin e të ardhurave – Information on the recipient of income:

Emri i plotë/Emri tregtar

Full name/Business name .....

Forma juridike

Legal form .....

Profesioni/aktiviteti

Profession/activity.....

Kodi fiskal ose NIPT

Fiscal code or TIN .....

Full address .....

Përfaqsimi në Shqipëri (nëse ka)

Representation in Albania (if any) .....

II. Të dhëna për paguesin e të ardhurave – Information on the payer of income:

Emri i plotë/Emri tregtar

Full name/Business name .....

Forma juridike

Legal form .....

Profesioni/aktiviteti

Profession/activity .....

Kodi fiskal ose NIPT

Fiscal code or TIN .....

Adresa e plotë

Full Address .....

III. Të dhëna mbi të ardhurat – Information on income:

Lloji i të ardhurës

Type of income .....

Shuma e të ardhurës

Total amount of income .....

Data e pagesës

Date of payment .....

Tarifa e tatimit dhe shuma e tatimit të paguar

Tax rate and amount of tax paid .....

IV. Të dhëna për dokumentat që bashkangjiten – Information on attached documents:

(lloji i dokumentave, numri dhe data e lëshimit – type of documents, number and issuing date)

.....  
.....  
.....  
.....  
.....

V. Të dhëna të tjera – Other information:

.....  
.....

VI. Deklarimi i kërkuesit (përfituesit) – Declaration of the claimant (beneficiary):

Unë deklaroj se jam pronari përfitues i të ardhurave të sipër-përmendura dhe se çdo e dhënë në këtë kërkesë është e vërtetë – I hereby declare that I am the beneficial owner of the above-mentioned income and any information given in this claim is true.

Vendi dhe data – Place and date

Firma dhe vula e përfituesit – Signature and Stamp of the beneficiary

.....

VII. Vërtetimi nga Autoriteti Tatimor i Vendlindjes së Rezidencës së përfituesit – Certification by the Tax Authority of the beneficiary's residence country.

Unë vërtetoj se përfituesi ka qenë/është rezident i ..... gjatë vitit të specifikuar më sipër në kuptimin e Nenit 3 të Marrëveshjes për heqjen e taksimit të dyfishtë midis Shqipërisë dhe .....

I certify that the beneficiary is/was during the year specified above a resident of ..... within the meaning of Article 3 of the Agreement for the avoidance of double taxation between Albania and .....

Vendi dhe data

Vula e Autoritetit Tatimor

Emri dhe nënshkrimi i punonjësit kompetent

Place and date

Stamp of Tax Authority

Name and Signature of competent official

.....

.....

#### UDHËZIME PËR PLOTËSIMIN E KËTIJ FORMULARI

1. Ky formular u jepet personave rezidentë të vendeve me të cilat Republika e Shqipërisë ka përfunduar marrëveshje për heqjen e taksimit të dyfishtë, ndaj të cilëve aplikohen dispozitat e këtyre marrëveshjeve lidhur me tatimet e mbajtura në burim ndaj dividendëve, interesave, honorarëve dhe shërbimeve teknike.

2. Formulari konsiston në katër kopjo, kopjo 1 për përfituesin, kopjo 2 për pagesin e të



ardhurave, kopjo 3 për Autoritetin Tatimor Shqiptar dhe kopjo 4 për Autoritetin e Huaj Tatimor. Rubrikat I, IV, V dhe VI plotësohen nga përfituesi (kërkuesi); rubrikat II dhe III nga paguesi dhe rubrika VII nga Autoriteti i Huaj Tatimor.

3. Aplikimi i plotësuar paraqitet në Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve në Republikën e Shqipërisë në adresën: Rr."Mustafa Lleshi" nr.7, Tiranë, Shqipëri, jo më vonë se dy vjet nga data e kryerjes së pagesës.

#### INSTRUCTIONS FOR FILLING IN THIS FORM

1. This form is submitted to resident persons of countries with which the Republic of Albania has concluded Agreements for the avoidance of double taxation and which persons are subject to the provisions of such Agreements concerning the withholding taxes on dividends, interest, royalties and technical services.

2. The form consists in four copies; copy 1 is for the beneficiary, copy 2 for the payer of income (remuneration), copy 3 for the Albanian Tax Authority and copy 4 for the Foreign Tax Authority. Items I, IV, V and VI are to be filled by the beneficiary (claimant); items II and III are to be filled by the payer and item VII is to be filled by the foreign tax authority.

3. The completed form is submitted to the General Taxation Department in the Republic of Albania at the address: Rr."Mustafa Lleshi" nr.7, Tirana, Albania, within the period of two years from the date of the payment.

REPUBLIKA E SHQIPERISE  
MINISTRIA E FINANCAVE  
DREJTORIA E PERGJITHSHME  
E TATIMEVE

REPUBLIC OF ALBANIA  
MINISTRY OF FINANCE  
GENERAL TAXATION  
DEPARTMENT

Rr. "Mustafa Lleshi", Nr. 7, Tirana Tel : (355 4) 374156 Fax: (355 4) 374159

Nr. \_\_\_\_ Prot.

Tiranë, \_\_ / \_\_ /2004

Kopjo 3 për autoritetin tatimor të –

Copy 3 for the tax authority of the

Republikës së Shqipërisë

Republic of Albania

KËRKESË PËR ZBATIMIN E MARRËVESHJES PËR HEQJEN E TAKSIMIT TË DYFISHTË  
MIDIS SHQIPËRISË DHE .....

CLAIM FOR THE APPLICATION OF THE AGREEMENT FOR THE AVOIDANCE OF DOUBLE  
TAXATION BETWEEN ALBANIA AND .....

I. Të dhëna për përfituesin e të ardhurave – Information on the recipient of income:

Emri i plotë/Emri tregtar  
Full name/Business name .....  
Forma juridike  
Legal form .....  
Profesioni/aktiviteti  
Profession/activity.....  
Kodi fiskal ose NIPT  
Fiscal code or TIN .....  
Adresa e plotë  
Full address .....  
Përfaqsimi në Shqipëri (nëse ka)  
Representation in Albania (if any) .....

II. Të dhëna për paguesin e të ardhurave – Information on the payer of income:

Emri i plotë/Emri tregtar  
Full name/Business name .....  
Forma juridike  
Legal form .....  
Profesioni/aktiviteti  
Profession/activity .....  
Kodi fiskal ose NIPT  
Fiscal code or TIN .....  
Adresa e plotë  
Full Address .....

III. Të dhëna mbi të ardhurat – Information on income:

Lloji i të ardhurës  
Type of income .....

Shuma e të ardhurës  
Total amount of income .....

Data e pagesës  
Date of payment .....  
Tarifa e tatimit dhe shuma e tatimit të paguar  
Tax rate and amount of tax paid .....

IV. Të dhëna për dokumentat që bashkangjiten – Information on attached documents:  
(lloji i dokumentave, numri dhe data e lëshimit – type of documents, number and issuing date)

.....  
.....  
.....  
.....

.....

V. Të dhëna të tjera – Other information:

.....

.....

.....

## VI. Deklarimi i kërkuarit (përfituesit) – Declaration of the claimant (beneficiary):

Unë deklaroj se jam pronari përfitues i të ardhurave të sipër-përmendura dhe se çdo e dhënë në këtë kërkesë është e vërtetë – I hereby declare that I am the beneficial owner of the above-mentioned income and any information given in this claim is true.

Vendi dhe data – Place and date                      Firma dhe vula e përfituesit – Signature and Stamp of the beneficiary

VII. Vërtëtimi nga Autoriteti Tatimor i Vendit të Rezidencës së përfituesit – Certification by the Tax Authority of the beneficiary's residence country.

Unë vërtetoj se përfituesi ka qenë/është rezident i ..... gjatë vitit të specifikuar më sipër në kuptimin e Nenit 3 të Marrëveshjes për heqjen e taksimit të dyfishtë midis Shqipërisë dhe

I certify that the beneficiary is/was during the year specified above a resident of ..... within the meaning of Article 3 of the Agreement for the avoidance of double taxation between Albania and

|                |                            |                                             |
|----------------|----------------------------|---------------------------------------------|
| Vendi dhe data | Vula e Autoritetit Tatimor | Emri dhe nënëshkrimi i punonjësit kompetent |
|----------------|----------------------------|---------------------------------------------|

|                |                        |                                          |
|----------------|------------------------|------------------------------------------|
| Place and date | Stamp of Tax Authority | Name and Signature of competent official |
|----------------|------------------------|------------------------------------------|

## UDHËZIME PËR PLOTESIMIN E KËTIJ FORMULARI

1. Ky formular u jepet personave rezidentë të vendeve me të cilat Republika e Shqipërisë ka përfunduar Marrëveshje për Heqjen e Taksimit të dyfishtë, ndaj të cilëve aplikohen dispozitat e këtyre marrëveshjeve lidhur me tatimet e mbajtura në burim ndaj dividendëve, interesave, honorareve dhe shërbimeve teknike.

2. Formulari konsiston në katër kopjo, kopjo 1 për përfituesin, kopjo 2 për paguesin e të ardhurave, kopjo 3 për Autoritetin Tatimor Shqiptar dhe kopjo 4 për Autoritetin e Huaj Tatimor. Rubrikat I, IV, V dhe VI plotsohen nga përfituesi (kërkuesi); rubrikat II dhe III nga paguesi dhe rubrika VII nga Autoriteti i Huaj Tatimor.

3. Aplikimi i plotsuar paraqitet në Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve në Republikën e Shqipërisë në Adresën: Rr.Mustafa Lleshi nr.7, Tiranë, Shqipëri, jo më vonë se dy vjet nga data e kryerjes së pagesës.

## INSTRUCTIONS FOR FILLING IN THIS FORM

1. This form is submitted to rezident persons of countries with which the Republic of Albania has concluded Agreements for the avoidance of double taxation and which persons are subject to the provisions of such Agreements concerning the withholding taxes on dividends, interest, royalties and technical services.

2. The form consists in four copies; copy 1 is for the beneficiary, copy 2 for the payer of income (remuneration), copy 3 for the Albanian Tax Authority and copy 4 for the Foreign Tax Authority. Items I, IV, V and VI are to be filled by the beneficiary (claimant); items II and III are to be filled by the payer and item VII is to be filled by the foreign tax authority.

3. The completed form is submitted to the General Taxation Department in the Republic of Albania at the address: Rr."Mustafa Lleshi" nr.7, Tirana, Albania, within the period of two years from the date of the payment.

REPUBLIKA E SHQIPERISE  
MINISTRIA E FINANCAVE  
DREJTORIA E PERGJITHSHME  
E TATIMEVE

REPUBLIC OF ALBANIA  
MINISTRY OF FINANCE  
GENERAL TAXATION  
DEPARTMENT

Rr. "Mustafa Lleshi", Nr. 7, Tirana Tel : (355 4) 374156 Fax: (355 4) 374159

Nr. \_\_\_\_ Prot.

Tiranë, \_\_ / \_\_ /2004

Kopjo 4 për autoritetin tatimor të huaj – Copy 4 for the foreign tax authority

KËRKESË PËR ZBATIMIN E MARRËVESHJES PËR HEQJEN E TAKSIMIT TË DYFISHTË  
MIDIS SHQIPËRISË DHE .....

CLAIM FOR THE APPLICATION OF THE AGREEMENT FOR THE AVOIDANCE OF DOUBLE  
TAXATION BETWEEN ALBANIA AND .....

I. Të dhëna për përfituesin e të ardhurave – Information on the recipient of income:

Emri i plotë/Emri tregtar  
Full name/Business name .....  
Forma juridike  
Legal form .....  
Profesioni/aktiviteti  
Profession/activity.....  
Kodi fiskal ose NIPT  
Fiscal code or TIN .....  
Adresa e plotë  
Full address .....  
Përfaqsimi në Shqipëri (nëse ka)  
Representation in Albania (if any) .....

II. Të dhëna për pagesin e të ardhurave – Information on the payer of income:

Emri i plotë/Emri tregtar  
Full name/Business name .....  
Forma juridike  
Legal form .....  
Profesioni/aktiviteti  
Profession/activity .....  
Kodi fiskal ose NIPT  
Fiscal code or TIN .....  
Adresa e plotë  
Full Address .....

III. Të dhëna mbi të ardhurat – Information on income:

Lloji i të ardhurës  
Type of income .....

Shuma e të ardhurës  
Total amount of income .....

Data e pagesës  
Date of payment .....

Tarifa e tatimit dhe shuma e tatimit të paguar  
Tax rate and amount of tax paid .....

IV. Të dhëna për dokumentat që bashkangjiten – Information on attached documents:  
(lloji i dokumentave, numri dhe data e lëshimit – type of documents, number and issuing date)

.....  
.....  
.....  
.....  
.....

V. Të dhëna të tjera – Other information:

.....  
.....  
.....

VI. Deklarimi i kërkuesit (përfituesit) – Declaration of the claimant (beneficiary):

Unë deklaroj se jam pronari përfitues i të ardhurave të sipër-përmendura dhe se çdo e dhënë në këtë kërkesë është e vërtetë – I hereby declare that I am the beneficial owner of the above-mentioned income and any information given in this claim is true.

Vendi dhe data – Place and date          Firma dhe vula e përfituesit – Signature and Stamp of the beneficiary  
.....

VII. Vërtëtimi nga Autoriteti Tatimor i Vendlindjes së përfituesit – Certification by the Tax Authority of the beneficiary's residence country.

Unë vërtetoj se përfituesi ka qenë/është rezident i ..... gjatë vitit të specifikuar më sipër në kuptimin e Nenit 3 të Marrëveshjes për heqjen e taksimit të dyfishtë midis Shqipërisë dhe .....

I certify that the beneficiary is/was during the year specified above a resident of ..... within the meaning of Article 3 of the Agreement for the avoidance of double taxation between Albania and .....

Vendi dhe data                                  Vula e Autoritetit Tatimor                                  Emri dhe nënshkrimi i  
punonjësit kompetent

Place and date                                  Stamp of Tax Authority                                  Name and Signature of  
competent official

.....

#### UDHËZIME PËR PLOTESIMIN E KËTIJ FORMULARI

1. Ky formular u jepet personave rezidentë të vendeve me të cilat Republika e Shqipërisë ka përfunduar Marrëveshje për Heqjen e Taksimit të dyfishtë, ndaj të cilëve aplikohen dispozitat e këtyre

marrëveshjeve lidhur me tatimet e mbajtura në burim ndaj dividendëve, interesave, honorareve dhe shërbimeve teknike..

2. Formulari konsiston në katër kopjo, kopjo 1 për përfituesin, kopjo 2 për paguesin e të ardhurave, kopjo 3 për Autoritetin Tatimor Shqiptar dhe kopjo 4 për Autoritetin e Huaj Tatimor. Rubrikat I, IV, V dhe VI plotsohen nga përfituesi (kërkuesi); rubrikat II dhe III nga paguesi dhe rubrika VII nga Autoriteti i Huaj Tatimor.

3. Aplikimi i plotsuar paraqitet në Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve në Republikën e Shqipërisë në Adresën: Rr.Mustafa Lleshi nr.7, Tiranë, Shqipëri, jo më vonë se dy vjet nga data e kryerjes së pagesës.

#### INSTRUCTIONS FOR FILLING IN THIS FORM

1. This form is submitted to resident persons of countries with which the Republic of Albania has concluded Agreements for the avoidance of double taxation and which persons are subject to the provisions of such Agreements concerning the withholding taxes on dividends, interest, royalties and technical services.

2. The form consists in four copies; copy 1 is for the beneficiary, copy 2 for the payer of income (remuneration), copy 3 for the Albanian Tax Authority and copy 4 for the Foreign Tax Authority. Items I, IV, V and VI are to be filled by the beneficiary (claimant); items II and III are to be filled by the payer and item VII is to be filled by the foreign tax authority.

3. The completed form is submitted to the General Taxation Department in the Republic of Albania at the address: Rr."Mustafa Lleshi" nr.7, Tirana, Albania, within the period of two years from the date of the payment.

#### MARRËVESHJET BILATERALE PËR SHMANGJEN E TAKSIMIT TË DYFISHTË DHE PARANDALIMIN E EVAZIONIT FISKAL (MARRËVESHJET TATIMORE)

I. Marrëveshjet tatimore që kanë hyrë në fuqi:

1. Marrëveshja me Poloninë, me efekt nga 1 Janari 1995.

2. Marrëveshja me Rumaninë, me efekt nga 1 Janari 1995.
3. Marrëveshja me Malajzinë, me efekt nga 1 Janari 1995.
4. Marrëveshja me Hungarinë, me efekt nga 1 Janari 1996.
5. Marrëveshja me Turqinë, me efekt nga 1 Janari 1997.
6. Marrëveshja me Çekinë, me efekt nga 1 Janari 1997.
7. Marrëveshja me Rusinë, me efekt nga 1 Janari 1998.
8. Marrëveshja me Maqedoninë, me efekt nga 1 Janari 1999.
9. Marrëveshja me Kroacinë, me efekt nga 1 Janari 1999.
10. Marrëveshja me Italinë, me efekt nga 1 Janari 2000.
11. Marrëveshja me Bullgarinë, me efekt nga 1 Janari 2000.
12. Marrëveshja me Suedinë, me efekt nga 1 Janari 2000.
13. Marrëveshja me Norvegjinë, me efekt nga 1 Janari 2000.
14. Marrëveshja me Greqinë, me efekt nga 1 Janari 2001.
15. Marrëveshja me Zvicrën, me efekt nga 1 Janari 2001.
16. Marrëveshja me Maltën, me efekt nga 1 Janari 2001.
17. Marrëveshja me Moldavinë, me efekt nga 1 Janari 2004.

II. Marrëveshje të nënëshkruara por që nuk kanë hyrë në fuqi:

18. Me Belgjikën,
  - Nënshkruar në Bruksel më 14 Nëntor 2002.
  - Ratifikuar nga Kuvendi i Shqiperise Prill 2003

19. Me Francën,
  - Nënshkruar në Tiranë më 24 Dhjetor 2002.
  - Ratifikuar nga Kuvendi i Shqipërisë, Prill 2003

III. Marrëveshje të sigluara në nivel teknik:

20. Me Egjiptin, parafuar në Kajro më 30 Nëntor, 1998.
21. Me Hollandën, parafuar në Hagë, më 14 Dhjetor, 2001.
22. Me Jugosllavinë, parafuar në Beograd më 11 Dhjetor 2002.
23. Me Iranin, parafuar në Teheran, më 22 Dhjetor 2002.

MINISTRIA E FINANCAVE

Dhjetor 2003

### **MARRËVESHJE**

**NDËRMJET QEVERISË SË REPUBLIKËS TË SHQIPËRISË DHE QEVERISË SË SHTETIT X  
PËR SHMANGJEN E TATIMEVE TË DYFISHTA DHE PËR PARANDALIMIN E EVAZIONIT  
FISKAL LIDHUR ME TATIMET MBI TË ARDHURAT DHE MBI KAPITALIN**

Qeveria e Republikës së Shqipërisë dhe Qeverija e Shtetit X,  
Duke dëshiruar të përfundojnë një marrëveshje për shmangjen e tatimeve të dyfishta dhe për parandalimin e evazionit fiskal lidhur me tatimet mbi të ardhurat dhe mbi kapitalin,



Kanë rënë dakort për sa vijon:

#### Neni 1

### **Personat mbi të cilat zbatohet marrëveshja**

Kjo Marrëveshje do të zbatohet ndaj personave që janë rezidentë të njërit ose e të dy Shteteve Kontraktuese.

#### Neni 2

### **Tatimet që mbulon marrëveshja**

1. Kjo Marrëveshje do të zbatohet për tatimet mbi të ardhurat dhe mbi kapitalin që zbatohen në emër të një Shteti Kontraktues ose nënndarjeve të tij politike ose autoriteve lokale, pavarësisht nga mënyra e vjeljes së tyre.

2. Do të konsiderohen tatime mbi të ardhurat dhe mbi kapitalin të gjitha tatimet e vendosura mbi të ardhurat total, mbi kapitalin në total ose mbi elemente të të ardhurave ose të kapitalit, përfshirë tatimet mbi fitimet nga shitblerja e pasurive të luajtshme ose të paluajtshme, tatimet mbi shumat totale të pagave dhe rrogave, si edhe tatimet mbi rivlerësimin e kapitalit.

3. Tatimet ekzistuese ndaj të cilave do të zbatohet Marrëveshja janë:

(a) Në rastin e Republikës së Shqipërisë:

(i) tatimi mbi fitimin;

(ii) tatimi mbi biznesin e vogël;

(iii) tatimi mbi të ardhurat personale;

(iv) tatimi mbi pasurinë;

(në vijim do t'i referohemi si "tatimet shqiptare").

(b) Në rastin e shtetit X:

(i) tatimi mbi të ardhurat e individëve;

(ii) tatimi mbi korporatat;

(iii) tatimet mbi pronësinë mbi tokën;

(iv) tatimi mbi ndërtesat;

(v) tatimi mbi biznesin lokal.

(në vijim do t'i referohemi si "tatimet e shtetit X").

4. Marrëveshja do të zbatohet gjithashtu për tatime të njëllorja ose esencialisht të ngjashme, të cilat do të vendosen pas datës së nënshkrimit të kësaj Marrëveshjeje si shtojcë ose në vend të tatimeve ekzistuese. Autoritetet kompetente të Shteteve Kontraktuese do të njoftojnë njëri -jetrin për çdo ndryshim thelbësor që është bërë në ligjet e tyre tatimore.

#### Neni 3

### **Përcaktime të përgjithshme**

1. Për qëllimet e kësaj Marrëveshjeje, përderisa përmbajtja të mos e kërkojë ndryshe:

(a) termi "Shqipëria" nënkupton Republikën e Shqipërisë dhe, i përdorur në sensin gjeografik, nënkupton territorin e Republikës së Shqipërisë, përfshirë ujrat territoriale dhe hapsirën ajrore mbi to, si edhe çdo zonë tej ujrave territoriale të Republikës së Shqipërisë, e cila, në përpunje me të drejtën ndërkombëtare dhe me ligjet e Republikës së Shqipërisë, është një zonë brenda së cilës Republika e Shqipërisë mund të ushtrojë të drejta lidhur me tabanin detar, nëntokën dhe burimet e tyre natyrore;

(b) termi "shteti X" nënkupton Republikën e Shtetit X dhe, kur përdoret në sensin gjeografik, përfshin edhe ujrat territoriale atje, tabanin detar dhe nëntokën e zonave detare përtej ujrave territoriale, mbi të cilat shteti X ushtron të drejtat sovraane, në përpunje me të drejtën ndërkombëtare për qëllim të zbulimit dhe shfrytëzimit të burimeve natyrore;

(c) termit "një Shtet Kontraktues" dhe "Shteti tjetër Kontraktues" nënkuptojnë Shqipërinë ose Shtetin X, siç e kërkon përmbajtja;

(d) termi "person" përfshin një individ, një shoqëri dhe çdo grup tjetër personash;

(e) termi “kompani” (shoqëri) nënkupton çdo trup korporativ ose çdo ent që trajtohet si person juridik për qëllime tatimore;

(f) termat “sipërmarrje e një Shteti Kontraktues” dhe “sipërmarrje e Shtetit tjetër Kontraktues” nënkuptojnë respektivisht një sipërmarrje të ushtruar nga një rezident i një Shteti Kontraktues dhe një sipërmarrje të ushtruar nga një rezident i shtetit tjetër Kontraktues;

(g) termi “tatim” nënkupton tatimin shqiptar ose tatimin e Shtetit X, siç e kërkon përmbajtja;

(h) termi “trafik ndërkombëtar” nënkupton çdo transport me anije apo avion apo mjet të transportit rrugor që operohet nga një sipërmarrje që ka vendin e drejtimit efektiv në një Shtet Kontraktues, përveç kur anija, avioni ose mjeti i transportit rrugor vepron vetëm midis vendeve të ndodhura në territorin e Shtetit tjetër Kontraktues;

(i) termi “autoritet kompetent” nënkupton:

i) në rastin e shtetit X, Ministrin e Financave ose përfaqësuesin e autorizuar prej tij; dhe

ii) në rastin e Shqipërisë, Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve.

(j) termi “nënshtetas” nënkupton:

i) çdo individ që zotëron nënshtetësinë e një Shteti Kontraktues;

ii) çdo person juridik, ortakëri ose shoqatë që gëzon statusin si e tillë nga ligjet në fuqi në një Shtet Kontraktues;

2. Përsa i përket zbatimit të Marrëveshjes nga një Shtet Kontraktues, çdo term i papërcaktuar këtu, përderisa përmbajtja të mos e kërkojë ndryshe, do të ketë kuptimin që i është dhënë sipas legjislacionit të atij shteti lidhur me tatimet e të cilit zbatohet Marrëveshja. Çdo kuptim në bazë të ligjeve tatimore të atij Shteti ka përparësi ndaj kuptimeve të tjera që mund t'i jepen termit nga ligje të tjera të atij Shteti.

#### Neni 4 **Rezidenti**

1. Për qëllime të kësaj Marrëveshjeje termi “rezident i një Shteti Kontraktues” nënkupton çdo person që, sipas ligjeve të atij Shteti, është subjekt i tatimeve atje për shkak të vendbanimit, rezidencës, vendit të drejtimit apo çdo kriteri tjetër të një natyre të ngjashme.

2. Kur për shkak të dispozitave të paragrafit 1, një individ është rezident i të dy Shteteve Kontraktues, atëherë statusi i tij do të përcaktohet si vijon:

(a) ai do të konsiderohet rezident i Shtetit në të cilin ai ka një banesë të përhershme në dispozicion të tij; në qoftë se ai ka një banesë të përhershme në dispozicion të tij në të dy Shtetet, ai do të konsiderohet rezident i Shtetit me të cilin interesat e tij personale dhe ekonomike janë të lidhura më ngushtë (qendra e interesave jetike);

(b) në qoftë se Shteti në të cilin ai ka qendrën e interesave jetike nuk mund të përcaktohet, ose nëqoftëse ai nuk ka një banesë të përhershme në dispozicion të tij në asnjërin Shtet, ai do të konsiderohet rezident i Shtetit në të cilin ai qëndron zakonisht;

(c) në qoftë se ai qëndron rregullisht në të dy Shtetet ose në asnjërin prej tyre, ai do të konsiderohet rezident i Shtetit në të cilin ai është nënshtetas;

(d) në qoftë se ai është nënshtetas i të dy Shteteve ose i asnjërit prej tyre, autoritetet kompetente të Shteteve Kontraktuese do ta zgjidhin këtë çështje me mirëkuptim reciprok.

3. Kur për shkak të dispozitave të paragrafit 1, një person jo individ është rezident i të dy Shteteve Kontraktues, atëherë ai do të konsiderohet rezident i Shtetit në të cilin është vendosur vendi i drejtimit efektiv të tij.

#### Neni 5 **Selia e përhershme**

1. Për qëllime të kësaj Marrëveshjeje termi “seli e përhershme” nënkupton një vend fiks biznesi nëpërmjet të cilit ushtrohet tërësisht ose pjesërisht biznesi i një sipërmarrjeje.

2. Termi “seli e përhershme” përfshin në veçanti:

(a) një vend drejtimi;

(b) një degë;  
(c) një zyrë;  
(d) një fabrikë;  
(e) një punishte;  
(f) një minierë, një pus naftë ose gazi, ose çdo vend tjetër për shfrytëzimin e burimeve natyrore;

(g) një fermë apo plantacion;

(h) ambiente apo magazina të përdorura si vende për shitje.

3. Termi “seli e përhershme”, gjithashtu, përfshin një shesh ndërtimi, një konstruksion, një projekt montimi ose instalimi apo aktivitete mbikqyrjeje të lidhura me to, por vetëm kur sheshe, projekte apo aktivitete të tilla vazhdojnë për një periudhë ose periudha që në total i kalojnë nëntë muaj, brenda çdo periudhe 12-mujore;

4. Pavarësisht nga dispozitat e mësipërme të këtij neni, termi “seli e përhershme” nuk do të përfshijë:

(a) përdorimin e pajisjeve apo objekteve vetëm për qëllime magazinimi ose ekspozimi të mallrave që i përkasin sipërmarrjes;

(b) mbajtjen e një gjendjeje mallrash që i përkasin sipërmarrjes vetëm për qëllime magazinimi ose ekspozimi;

(c) mbajtjen e një gjendjeje mallrash që i përkasin sipërmarrjes vetëm për qëllime përpunimi nga një sipërmarrje tjetër;

(d) mbajtjen e një vendi fiks biznesi vetëm me qëllim blerjen e mallrave ose për mbledhje informacioni për sipërmarrjen;

(e) mbajtjen e një vendi fiks biznesi vetëm për qëllim të ushtrimit, për sipërmarrjen, të çdo aktiviteti tjetër me karakter përgatitor ose ndihmës;

(f) mbajtjen e një vendi fiks biznesi vetëm për çdo kombinim të aktiviteteve të përmendura në nënparagrafët (a) deri (e), me kusht që aktiviteti në kompleks i këtij vendi fiks biznesi që rezulton nga ky kombinim të jetë i një karakteri përgatitor ose ndihmës.

5. Pavarësisht nga dispozitat e paragrafëve 1 dhe 2, kur një person - i ndryshëm nga një agjent me status të pavarur ndaj të cilit zbatohet paragrafi 7 - vepron në një Shtet Kontraktues në emër të një sipërmarrjeje të Shtetit tjetër Kontraktues, kjo sipërmarrjeje do të konsiderohet se ka një seli të përhershme në Shtetin Kontraktues të përmendur në fillim lidhur me çdo aktivitet që ai person ndërmerr për sipërmarrjen, në qoftë se personi ka dhe zakonisht e ushtron në Shtetin e përmendur në fillim një autoritet për të përfunduar kontrata në emër të sipërmarrjes, përveç kur aktivitetet e këtij personi kufizohen në ato të përmendura në paragrafin 4, të cilat, edhe pse ushtrohen nëpërmjet një vendi fiks biznesi, nuk e bëjnë këtë vend fiks biznesi një seli të përhershme sipas dispozitave të atij paragrafi.

6. Një sipërmarrjeje e një Shteti Kontraktues nuk do të konsiderohet se ka një seli të përhershme në Shtetin tjetër Kontraktues vetëm për faktin se ajo ushtron biznesin në këtë Shtet tjetër nëpërmjet një ndërmjetësi, komisioneri të përgjithshëm apo çdo lloj agjenti tjetër me një status të pavarur, me kusht që të tillë persona veprojnë brenda kuadrit të zakonshëm të aktivitetit të tyre. Megjithatë, kur aktivitetet e një ndërmjetësi të tillë kryhen tërësisht ose thuajse tërësisht në emër të asaj sipërmarrjeje ai (ndërmjetësi) nuk do të konsiderohet një agjent me një status të pavarur në kuptimin e këtij paragrafi.

7. Fakti që një kompani që është rezidente e një Shteti Kontraktues kontrollon ose kontrollohet nga një kompani që është rezidente e Shtetit tjetër Kontraktues, ose që ushtron aktivitet në atë Shtet tjetër (nëpërmjet një selie të përhershme ose në formë tjetër), nuk përbën në vetvete arsye të mjaftueshme për ta konsideruar një kompani seli të përhershme të tjetrës.

## Neni 6

### **Të ardhurat nga pasuria e paluajtshme**

1. Të ardhurat e realizuara nga një rezident i një Shteti Kontraktues nga pasuria e paluajtshme (përfshirë të ardhurat nga bujqësia dhe pyjet) të vendosura në Shtetin tjetër Kontraktues mund të tatohen në këtë Shtet tjetër.

2. Termi “pasuri e paluajtshme” do të ketë kuptimin që ka sipas ligjit të Shtetit Kontraktues ku

është vendosur prona në fjalë. Në çdo rast, ky term do të përfshijë pasuritë aksesore të pasurisë së paluajtshme, inventarin e gjallë dhe pajisjet e përdorura në bujqësi e në pyje, të drejtat ndaj të cilave zbatohen dispozitat e legjislacionit të përgjithshëm lidhur me pronën mbi tokën, uzufрукti i pasurive të paluajtshme dhe të drejtat ndaj pagesave fikse ose variabël për shfrytëzimin ose të drejtën për të shfrytëzuar vendburimet minerare dhe burime e pasuri të tjera natyrore. Anijet, varkat dhe avionët nuk konsiderohen pasuri e paluajtshme.

3. Dispozitat e paragrafit 1 do të zbatohen edhe ndaj të ardhurave të realizuara nga përdorimi direkt, dhënia me qira ose përdorimi në çdo formë tjetër i pasurive të paluajtshme.

4. Dispozitat e paragrafëve 1 dhe 3 do të zbatohen gjithashtu ndaj të ardhurave nga pasuria e paluajtshme e një sipërmarrjeje dhe ndaj të ardhurave nga pasuria e paluajtshme e përdorur për kryerjen e shërbimeve personale të pavarura.

#### Neni 7

#### **Fitimet nga biznesi**

1. Fitimet e një sipërmarrjeje të një Shteti Kontraktues do të tatohen vetëm në atë Shtet, përveç kur sipërmarrja ushtron aktivitet në Shtetin tjetër Kontraktues nëpërmjet një selie të përhershme të vendosur aty. Në qoftë se sipërmarrja ushtron aktivitetin në mënyrën e sipërpërmendur, fitimet e sipërmarrjes mund të tatohen në Shtetin tjetër, por vetëm ajo pjesë e tyre që i atribuohet asaj selie të përhershme.

2. Pa cenuar dispozitat e paragrafit 3 të këtij neni, kur një sipërmarrje e një Shteti Kontraktues ushtron biznes në Shtetin tjetër Kontraktues nëpërmjet një selie të përhershme të vendosur aty, atëherë në secilin Shtet Kontraktues selisë së përhershme do t'i atribuohen fitimet që ajo do të realizonte sikur të ishte një sipërmarrje e veçantë dhe e pavarur që do të vepronte në të njëjtin aktivitet ose në aktivitete të ngjashme, nën kondita të njëjta ose të ngjashme, tërësisht e pavarur nga sipërmarrja seli e përhershme e së cilës ajo është.

3. Në përcaktimin e fitimeve të një selie të përhershme, lejohet zbritja e shpenzimeve që janë kryer për qëllimet e biznesit të selisë së përhershme, përfshirë shpenzimet e përgjithshme administrative dhe ekzekutive të kryera si në Shtetin ku ndodhet selia e përhershme, ashtu edhe gjetkë.

4. Përderisa për përcaktimin e fitimeve që do t'i atribuohen një selie të përhershme në një Shtet Kontraktues është përdorur metoda e ndarjes së fitimeve totale të sipërmarrjes në pjesët e saj të ndryshme, dispozitat e paragrafit 2 nuk e pengojnë atë Shtet Kontraktues për përcaktimin e fitimeve që do të tatohen me një metodë të tillë, siç mund të jetë vepruar zakonisht; megjithatë, metoda e ndarjes e adoptuar, duhet të jetë e tillë që rezultati të përputhet me parimet që përmban ky nen.

5. Asnjë fitim nuk mund t'i atribuohet një selie të përhershme vetëm për faktin se kjo seli e përhershme blen mallra për sipërmarrjen.

6. Për qëllimet e paragrafëve të mësipërm, fitimet që do t'i atribuohen selisë së përhershme do të përcaktohen me të njëjtën metodë vit pas viti, përderisa të mos ketë arsye të forta për të vepruar ndryshe.

7. Kur fitimet përmbajnë elementë të të ardhurave që trajtohen veças në nene të tjera të kësaj Marrëveshjeje, atëherë dispozitat e atyre neneve nuk do të ndikohen nga dispozitat e këtij neni.

#### Neni 8

#### **Transporti ndërkombëtar**

1. Fitimet nga veprimtaria e anijeve apo avionëve në trafikun ndërkombëtar do të tatohen vetëm në Shtetin Kontraktues ku ndodhet vendi i drejtimit efektiv të sipërmarrjes.

2. Nëse vendi i drejtimit efektiv i një sipërmarrjeje detare ndodhet në bordin e një anijeje, atëherë ajo do të konsiderohet e vendosur në Shtetin Kontraktues në të cilin ndodhet porti i qëndrimit të zakonshëm të anijes, ose, nëse nuk ka një port të tillë, në Shtetin Kontraktues rezident i të cilit është operuesi i anijes.

3. Dispozitat e paragrafit 1 të këtij neni do të zbatohen gjithashtu ndaj fitimeve të realizuara nga pjesëmarrja në një bashkësi, një biznes të përbashkët apo në një agjenci ndërkombëtare transporti.

## Neni 9

### Sipërmarrje të lidhura

#### 1. Kur:

(a) një sipërmarrje e një Shteti Kontraktues merr pjesë direkt ose indirekt në drejtimin, kontrollin ose kapitalin e një sipërmarrjeje të Shtetit tjetër Kontraktues, ose

(b) të njëjtët persona marrin pjesë direkt ose indirekt në drejtimin, kontrollin apo kapitalin e një sipërmarrjeje të një Shteti Kontraktues dhe të një sipërmarrjeje të Shtetit tjetër Kontraktues,

dhe në secilin rast kushtet që janë pranuar ose që janë diktuar midis dy sipërmarrjeve në marrdhëniet e tyre tregtare apo financiare ndryshojnë nga ato që do të vendoseshin midis sipërmarrjeve të pavarura, atëherë çdo fitim që do të realizohej nga njëra sipërmarrje, por që për shkak të lidhjeve të veçanta të përmendura në fillim nuk është realizuar, mund të përfshihet në fitimet e asaj sipërmarrjeje dhe të tatohet normalisht.

2. Kur një Shtet Kontraktues përfshin në fitimet e një sipërmarrjeje të atij Shteti - dhe i tatton ato normalisht - fitime për të cilat një sipërmarrjeje e Shtetit tjetër Kontraktues është rënduar me tatim në atë Shtet tjetër dhe fitimet e përfshira në këtë mënyrë janë fitime që do të ishin realizuar nga sipërmarrja e Shtetit të përmendur në fillim nëse konditat e krijuara midis dy sipërmarrjeve kanë qenë ato që do të vendoseshin midis sipërmarrjeve të pavarura, atëherë ai Shtet tjetër do të bëjë një rregullim në masën e duhur të shumës së tatimit të vendosur në atë Shtet mbi këto fitime. Në përcaktimin e rregullimeve të tilla duhet t'i kushtohet vëmendje edhe dispozitave të tjera të kësaj Marrëveshjeje.

## Neni 10

### Dividentët

1. Dividentët e paguar nga një kompani që është rezidente e një Shteti Kontraktues një rezidenti të Shtetit tjetër Kontraktues mund të tatohen në këtë Shtet tjetër.

2. Megjithatë, të tillë dividentë mund të tatohen gjithashtu në Shtetin Kontraktues rezidente e të cilit është kompania paguese e dividentëve dhe në përputhje me ligjet e këtij Shteti, por nëse marrësi është pronari përfitues i dividentëve tatimi i ngarkuar nuk do të kalojë 10 për qind të shumës bruto të dividentëve. Autoritetet kompetente të Shteteve Kontraktuese do të zgjidhin me mirëkuptim reciprok mënyrën e aplikimit të këtij kufizimi. Dispozitat e këtij paragrafi nuk do të kenë efekt mbi tatimin e kompanisë lidhur me fitimet nga të cilat janë paguar dividentët.

3. Në funksion të këtij neni, termi “dividentë” nënkupton të ardhurat nga aksionet e çdo lloji ose të drejta të tjera, që nuk janë kërkesa borxhi, pjesëmarrja në fitime, si edhe të ardhurat nga të drejta të tjera korporative që i nënshtrohen të njëjtit trajtim tatimor, si të ardhurat nga aksionet nga ligjet e Shtetit rezidente e të cilit është kompania që bën shpërndarjen e dividentëve.

4. Dispozitat e paragrafëve 1 dhe 2 të këtij neni nuk do të zbatohen nëse pronari përfitues i dividentëve, duke qenë rezident i një Shteti Kontraktues, ushtron aktivitet në Shtetin tjetër Kontraktues rezidente e të cilit është kompania paguese e dividentëve, nëpërmjet një selie të përhershme të vendosur aty, ose kryen në atë Shtet tjetër shërbime personale të pavarura nga një bazë fikse të vendosur aty, dhe zotërimi lidhur me të cilin janë paguar dividentët është efektivisht i lidhur me këtë seli të përhershme ose bazë fikse. Në këtë rast do të zbatohen dispozitat e Nenit 7 ose nenit 14, si të paraqitet rasti.

5. Kur një kompani që është rezidente e një Shteti Kontraktues realizon fitime ose të ardhura nga Shteti tjetër Kontraktues, ky Shtet tjetër mund të mos zbatojë tatim mbi dividentët e paguar nga kompania, përveç kur këto dividentë i paguhen një rezidenti të Shtetit tjetër ose kur zotërimi lidhur me të cilin janë paguar dividentët është efektivisht i lidhur me një seli të përhershme ose një bazë fikse të vendosur në këtë Shtet tjetër. Subjekt i tatimit mbi fitimet e pashpërndara nuk janë gjithashtu as fitimet e pashpërndara të kompanisë, edhe sikur dividentët e paguar ose fitimet e pashpërndara konsistojnë tërësisht ose pjesërisht si fitime apo të ardhura të realizuara në këtë Shtet tjetër.

## Neni 11

### Interesat

1. Interesat që krijohen në një Shtet Kontraktues dhe i paguhet një rezidenti të Shtetit tjetër Kontraktues mund të tatohen në këtë Shtet tjetër.

2. Megjithatë, këto interesa mund të tatohen edhe në Shtetin Kontraktues ku ato krijohen dhe në përputhje me ligjet e këtij Shteti, por kur marrësi është pronari përfitues i interesave, tatimi i zbatuar nuk duhet të kalojë 10 për qind të shumës bruto të interesit. Autoritetet kompetente të Shteteve Kontraktuese do të vendosin me mirëkuptim reciprok mënyrën e zbatimit të këtij kufizimi.

3. Pavarësisht nga dispozitat e paragrafit 2, interesat e krijuara në një Shtet Kontraktues do të përjashtohen nga tatimi në atë Shtet në qoftë se paguesi i interesit është qeveria e atij Shteti Kontraktues ose një autoritet lokal atje.

4. Termi “interesa”, në kuptimin e përdorur në këtë nen nënkupton të ardhurat nga kërkesat e borxhit të çdo lloji, të siguruara ose jo me hipotekim ndaj pasurive, dhe që e kanë ose jo të drejtën e pjesëmarrjes në fitimet debitorit, dhe në veçanti të ardhurat nga bonot e thesarit dhe obligacionet, përfshirë çmimet dhe shpërblimet që i shtohen këtyre bonove dhe obligacioneve.

5. Dispozitat e paragrafëve 1 dhe 2 të këtij neni nuk do të zbatohen në qoftë se pronari përfitues i interesave, duke qenë një rezident i një Shteti Kontraktues, ushtron biznes në Shtetin tjetër Kontraktues ku krijohen interesat, nëpërmjet një selie të përherëshme të vendosur aty, ose kryen në atë Shtet tjetër shërbime personale të pavarura nga një bazë fikse të vendosur aty, dhe kërkesa e huasë lidhur me të cilën paguhet interesi është efektivisht e lidhur me këtë seli të përherëshme ose bazë fikse. Në këtë rast do të zbatohen dispozitat e nenit 7 ose nenit 14, si të paraqitet rasti.

6. Interesat do të konsiderohen se krijohen në një Shtet Kontraktues kur paguesi është vetë ai Shtet, një autoritet lokal ose një rezident i atij Shteti. Megjithatë, kur personi që paguan interesat, qoftë ose jo rezident i njërit Shtet Kontraktues, ka në njërin Shtet Kontraktues një seli të përherëshme ose një bazë fikse në lidhje me të cilën ka lindur huaja për të cilën paguhet interesi, dhe këto interesa krijohen nga kjo seli e përherëshme ose bazë fikse, atëherë këto interesa do të konsiderohen se janë krijuar në Shtetin ku është vendosur selia e përherëshme ose baza fikse.

7. Kur, për shkak të lidhjeve të veçanta midis paguesit dhe pronarit përfitues të interesave ose midis të dyve dhe personave të tretë, shuma e interesave, bazuar në huanë për të cilën ato paguhet, e kalon shumën mbi të cilën duhej të ishte rënë dakord midis paguesit dhe pronarit përfitues në mungesë të marrëdhënieve të tilla, dispozitat e këtij neni do të zbatohen vetëm mbi shumën e përmendur në fund. Në këtë rast, pjesa që kalon pagesën normale do të mbetet e tatueshme në përputhje me ligjet e secilit Shtet Kontraktues, duke patur parasysh edhe dispozitat e tjera të kësaj Marrëveshjeje.

## Neni 12

### **Të ardhurat nga e drejta e autorit (honoraret)**

1. Honoraret (të ardhurat nga e drejta e autorit) që krijohen në një Shtet Kontraktues dhe i paguhet një rezidenti të Shtetit tjetër Kontraktues mund të tatohen në këtë Shtet tjetër.

2. Megjithatë, këto të ardhura mund të tatohen gjithashtu në Shtetin Kontraktues ku krijohen dhe në përputhje me ligjet e këtij Shteti, por, nëse marrësi është pronari përfitues i honorareve, tatimi i ngarkuar nuk duhet të kalojë 10 për qind të shumës bruto të honorarit. Autoritetet kompetente të Shteteve Kontraktuese do të vendosin me mirëkuptim reciprok për mënyrën e zbatimit të këtij kufizimi.

3. Termi “honorare” nën dispozitat e këtij Neni nënkupton pagesat e çdo lloji marra si shpërblim për përdorimin ose të drejtën e përdorimit të së drejtës së autorit për punimet letrare, artistike ose shkencore, përfshirë filmat kinematografikë dhe regjistrimet për transmetime radio-televizive, çdo patentë, markë tregtare, skicë ose model, plan, proces ose formulë sekrete, ose për përdorimin, ose për të drejtën e përdorimit të informacioneve lidhur me eksperiencën industriale tregtare apo shkencore.

4. Dispozitat e paragrafëve 1 dhe 2 nuk do të zbatohen nëse pronari përfitues i honorareve, duke qenë rezident i një Shteti Kontraktues, ushtron biznes në Shtetin tjetër Kontraktues ku krijohen honoraret, nëpërmjet një selie të përherëshme të vendosur aty, ose kryen në atë Shtet tjetër shërbime personale të pavarura nga një bazë fikse të vendosur aty, dhe e drejta ose prona lidhur me të cilën paguhet honoraret është efektivisht e lidhur me këtë seli të përherëshme ose bazë fikse. Në këtë rast do të zbatohen dispozitat e nenit 7 ose nenit 14, si të paraqitet rasti.

5. Honoraret do të konsiderohet se krijohen në një Shtet Kontraktues kur pagues është vetë ai

Shtet, një nënndarje politike, një autoritet lokal ose një rezident i atij Shteti. Megjithatë, kur personi që paguan honoraret, qoftë ose jo rezident i një Shteti Kontraktues, ka në njërin Shtet Kontraktues një seli të përhershme ose një bazë fikse në lidhje me të cilën ka lindur e drejta e pagimit të honorareve, dhe këto honorare kanë lindur nga kjo seli e përhershme ose bazë fikse, atëherë këto honorare do të konsiderohen se kanë lindur në Shtetin Kontraktues ku është vendosur selia e përhershme ose baza fikse.

6. Kur për shkak të lidhjeve të veçanta midis paguesit dhe pronarit përfitues ose midis të dyve dhe personave të tretë, shuma e honorareve, duke patur parasysh përdorimin, të drejtën apo informacionin për të cilin ato janë paguar, e kalon shumën për të cilën do të ishte rënë dakord midis paguesit dhe pronarit përfitues në mungesë të marrëdhënieve të tilla, atëherë dispozitat e këtij neni do të zbatohen mbi shumën e përmendur në fund. Në një rast të tillë shuma e shpërblimit që kalon shpërblimin normal mbetet e tatueshme sipas ligjeve përkatëse të secilit Shtet Kontraktues, duke pasur parasysh dispozitat e tjera të kësaj Marrëveshje.

#### Neni 13

##### **Fitimet nga tjetërsimi i kapitalit**

1. Fitimet e realizuara nga një rezident i një Shteti Kontraktues nga tjetërsimi i pasurive të paluajtshme që i referohen Nenit 6 të kësaj Marrëveshjeje dhe të vendosura në Shtetin tjetër Kontraktues mund të tatohen në këtë shtet tjetër.

2. Fitimet nga tjetërsimi i pasurive të luajtshme që bëjnë pjesë në pasuritë e biznesit të një selie të përhershme që një sipërmarrje e një Shteti Kontraktues ka në Shtetin tjetër Kontraktues ose i pasurive të luajtshme që i përkasin një baze fikse që një rezident i një Shteti Kontraktues ka në Shtetin tjetër Kontraktues për të kryer shërbime personale të pavarura, përfshirë edhe fitimet nga tjetërsimi i vetë selisë së përhershme (vetëm ose bashkë me sipërmarrjen) ose i bazës fikse, mund të tatohen në këtë Shtet tjetër.

3. Fitimet e realizuara nga tjetërsimi i anijeve, avionëve ose mjeteve të transportit rrugor që veprojnë në trafikun ndërkombëtar ose i pasurive të luajtshme që i përkasin veprimtarisë së këtyre anijeve, avionëve apo mjeteve të transportit rrugor do të tatohen vetëm në Shtetin Kontraktues në të cilin ndodhet vendi i drejtimit efektiv të sipërmarrjes.

4. Fitimet nga tjetërsimi i çdo pasurie që nuk mbulohet nga paragrafët e mëparshëm të këtij neni mund të tatohen në Shtetin Kontraktues ku është rezident përfituesi.

#### Neni 14

##### **Shërbimet personale të pavarura**

1. Të ardhurat e realizuara nga një individ i cili është rezident i një Shteti Kontraktues, lidhur me shërbime profesionale ose aktivitete të tjera të një karakteri të pavarur, do të tatohen vetëm në atë Shtet përveç në rrethanat që vijnë, kur të ardhura të tilla mund të tatohen gjithashtu edhe në Shtetin tjetër Kontraktues:

a) nëse ai ka një bazë fikse në dispozicion të tij në Shtetin tjetër Kontraktues që rregullisht i shërben atij për të kryer aktivitetet e tij; në këtë rast, vetëm ajo pjesë e të ardhurave që i atribuohen kësaj baze fikse mund të tatohen në këtë Shtet tjetër Kontraktues; ose

b) nëse qëndrimi i tij në Shtetin tjetër Kontraktues është për një periudhë ose periudha që në total arrijnë ose kalojnë 183 ditë në çdo periudhë 12-mujore që fillon ose përfundon në vitin përkatës kalendarik; në këtë rast, vetëm ajo pjesë e të ardhurave të realizuara nga aktivitetet e tij të kryera në këtë Shtet tjetër mund të tatohen në këtë Shtet tjetër.

2. Termi “shërbime profesionale” përfshin në veçanti aktivitetet e pavarura shkencore, letrare, artistike, arsimore apo mësimdhënieje, si dhe aktivitetet e pavarura të mjekëve, avokatëve, inxhinierëve, arkitektëve, dentistëve dhe llogaritarëve.

#### Neni 15

##### **Shërbimet personale të varura**

1. Pa cenuar dispozitat e neneve 16, 18 dhe 19, pagat dhe shpërblime të tjera të ngjashme që përfitohen nga një rezident i një Shteti Kontraktues nga punësimi i tij do të tatohen vetëm në këtë Shtet Kontraktues, përveç kur puna është ushtruar në Shtetin tjetër Kontraktues. Nëse puna ushtrohet në këtë mënyrë (pra në Shtetin tjetër Kontraktues), atëherë këto të ardhura mund të tatohen në këtë Shtet tjetër.

2. Përfshirë dispozitat e paragrafit 1, shpërblimet e përfituara nga një rezident i një Shteti Kontraktues lidhur me punën e ushtruar në Shtetin tjetër Kontraktues do të tatohen vetëm në Shtetin e përmendur në fillim, në qoftë se plotësohen të gjitha konditat e mëposhtme:

a) përfituesi (marrësi) është prezent në Shtetin tjetër për një periudhë ose periudha që nuk i kalojnë në total 183 ditë në vitin fiskal përkatës; dhe

b) shpërblimi paguhet nga, ose në emër të një punëdhënësi që nuk është rezident i Shtetit tjetër; dhe

c) shpërblimi nuk ka lindur nga një seli e përherëshme ose bazë fikse që punëdhënësi ka në Shtetin tjetër.

3. Pavarësisht nga dispozitat e mëparshme të këtij neni, shpërblimet e realizuara nga një rezident i një Shteti Kontraktues lidhur me punën e ushtruar në bordin e një anije ose avioni që vepron në trafikun ndërkombëtar, mund të tatohen në Shtetin Kontraktues në të cilin ndodhet qendra efektive e drejtimit të sipërmarrjes.

#### Neni 16

### **Shpërblimet e drejtorëve**

Shpërblimet e drejtorëve dhe pagesa të tjera të ngjashme të realizuara nga një rezident i një Shteti Kontraktues në pozitën e tij si anëtar i këshillit të drejtorëve ose çdo organi të ngjashëm të një shoqërie që është rezident i Shtetit tjetër Kontraktues, mund të tatohen në këtë Shtet tjetër.

#### Neni 17

### **Artistët dhe sportistët**

1. Pavarësisht nga dispozitat e neneve 14 dhe 15, të ardhurat e realizuara nga një rezident i një Shteti Kontraktues si një artist, si aktor teatri, kinematografie, radiotelevizioni, muzikant, apo si sportist, nga aktiviteti i tij personal si i tillë, i ushtruar në Shtetin tjetër Kontraktues, mund të tatohen në këtë Shtet tjetër.

2. Kur të ardhurat lidhur me aktivitetet personale të ushtruara nga një artist ose sportist në pozitën e tij si i tillë realizohen jo direkt nga sportisti apo artisti por nga një person tjetër, këto të ardhura, pavarësisht nga dispozitat e neneve 7, 14 dhe 15, mund të tatohen në Shtetin Kontraktues në të cilin janë ushtruar aktivitetet e artistit apo sportistit.

3. Të ardhurat e realizuara nga artistët ose sportistët që janë rezidentë të një Shteti Kontraktues do të përjashtohen nga tatimi në Shtetin tjetër Kontraktues në të cilin këto aktivitete ushtrohen në qoftë se aktivitetet ushtrohen brenda kuadrit të një vizite që kryesisht mbështetet nga njëri apo të dy Shtetet Kontraktuese, ose nga nënndarje politike apo administrative, autoritete lokale apo institucione publike atje. Në një rast të tillë, të ardhurat tatohen vetëm në Shtetin Kontraktues rezident i të cilit është artisti ose sportisti.

#### Neni 18

### **Pensionet**

Pensionet dhe shpërblime të tjera të ngjashme që krijohen në një Shtet Kontraktues dhe i paguhet një rezidenti të Shtetit tjetër Kontraktues lidhur me punësimin e tij në të kaluarën do të tatohen vetëm në atë Shtet.

#### Neni 19

### **Shërbimet qeveritare**

1. a) Shpërblimet, të ndryshme nga pensionet, të paguara nga një Shtet Kontraktues, një nënndarje politike apo nga një autoritet lokal atje një individ lidhur me shërbimet që ai i ka kryer atij Shteti, nënndarje politike apo autoriteti do të tatohen vetëm në atë Shtet.



b) Megjithatë, këto shpërblime do të tatohen vetëm në Shtetin tjetër Kontraktues, nëse shërbimet janë kryer në atë Shtet dhe individit është rezident i atij Shteti, i cili (individit):

i) është nënështetas i atij Shteti; ose

ii) nuk është bërë rezident i atij Shteti vetëm për qëllim të kryerjes së shërbimeve.

2. a) Çdo pension i paguar nga, apo prej fondeve të krijuara, prej një Shteti Kontraktues ose një nënndarjeje politike apo administrative ose një autoritet lokal atje, një individ lidhur me shërbimet e kryera atij Shteti ose nënndarje apo autoriteti do të tatohen vetëm në atë Shtet.

b) Megjithatë, këto pensione do të tatohen vetëm në Shtetin tjetër Kontraktues nëse individit është nënështetas dhe rezident i atij Shteti.

3. Dispozitat e neneve 15, 16 dhe 18 do të zbatohen mbi shpërblimet dhe pensionet lidhur me shërbimet e kryera lidhur me një aktivitet biznesi të ushtruar nga një Shtet Kontraktues, një nënndarje politike apo autoritet lokal atje.

#### Neni 20

#### **Studentët, petagogët dhe kërkuesit shkencorë**

1. Një rezident i një Shteti Kontraktues, që është përkohësisht prezent në Shtetin tjetër Kontraktues si një student në një universitet, kolegji ose shkollë, si një specializant teknik apo biznesi, nuk do të tatohet në atë Shtet tjetër për çdo pagesë apo shpërblim që merr për të përballuar jetesën, arsimimin apo trajnimin, me kusht që pagesa apo shpërblime të tilla të kryhen nga burime jashtë këtij Shteti tjetër.

2. Të ardhurat që studentët ose specializantët realizojnë nga punësimi i përkohshëm në shtetin ku ata ndodhen për qëllime studimi apo specializimi, do të gëzojnë të njejtat përjashtime apo lehtësi tatimore si studentët apo specializantët vendas.

3. Kur një rezident i një Shteti Kontraktues i cili, me ftesë të një universiteti, kolegji ose institucioni tjetër shkencor që ndodhet në Shtetin tjetër Kontraktues, viziton këtë Shtet tjetër me qëllim vetëm të mësimdhënjes apo kërkimit shkencor për një periudhë që nuk i kalon dy vjet nuk do të tatohet në këtë Shtet tjetër për shpërblimet e marra për mësimdhënien apo kërkimin shkencor, me kusht që të tilla shpërblime të jepen nga burime jashtë këtij Shteti tjetër.

4. Dispozitat e paragrafit 3 të këtij neni nuk do të zbatohen ndaj të ardhurave të realizuara nga puna kërkimore, e cila nuk kryhet për interesat publike, por kryesisht për interesa personale të një personi apo personave të veçantë.

#### Neni 21

#### **Të ardhura të tjera**

1. Lloje të të ardhurave të një rezidenti të një Shteti Kontraktues, kudo që të krijohen, që nuk lidhen me artikujt e mëparshëm të kësaj Marrëveshje do të tatohen vetëm në atë Shtet.

2. Dispozitat e paragrafit 1 nuk do të zbatohen ndaj të ardhurave, që nuk janë të ardhura nga pasuria e paluajtshme të përcaktuara në paragrafin 2 të nenit 6, nëse përfituesi i këtyre të ardhurave, duke qenë rezident i një Shteti Kontraktues, ushtron biznes në Shtetin tjetër Kontraktues nëpërmjet një selie të përhershme të vendosur aty, ose kryen në atë Shtet tjetër shërbime personale të pavarura nga një bazë fikse e vendosur aty, dhe e drejta ose pasuria lidhur me të cilën paguhet shpërblimi është efektivisht e lidhur me këtë seli të përhershme ose bazë fikse. Në këtë rast këto lloje të të ardhurave janë të tatueshme në këtë Shtet tjetër Kontraktues në përputhje me legjislacionin e tij.

#### Neni 22

#### **Kapitali**

1. Kapitali i përfaqësuar nga pasuri të paluajtshme që i referohen nenit 6, të zotëruara nga një rezident i një Shteti Kontraktues dhe të vendosura në Shtetin tjetër Kontraktues, mund të tatohen në këtë Shtet tjetër.

2. Kapitali i përfaqësuar nga pasuri të luajtshme që bëjnë pjesë në pasurinë e biznesit të një selie të përhershme që një sipërmarrje e një Shteti Kontraktues ka në Shtetin tjetër Kontraktues ose

nga pasuri të luajtshme që i përkasin një baze fikse në dispozicion të një rezidenti të një Shteti Kontraktues në Shtetin tjetër Kontraktues për kryerjen e shërbimeve personale të pavarura, mund të taten në këtë Shtet tjetër.

3. Kapitali i përfaqësuar nga anijet dhe avionët që veprojnë në trafikun ndërkombëtar, si dhe pasuritë e luajtshme që i përkasin aktivitetit të këtyre anijeve dhe avionëve, do të taten vetëm në Shtetin Kontraktues në të cilin ndodhet qendra e drejtimit efektiv të sipërmarrjes.

4. Të gjithë elementet e tjera të kapitalit të një rezidenti të një Shteti Kontraktues do të taten vetëm në këtë Shtet.

#### Neni 23

##### **Eliminimi i tatimit të dyfishta**

1. Kur një rezident i një Shteti Kontraktues realizon të ardhura ose zotëron kapitale, të cilat në përputhje me dispozitat e kësaj Marrëveshjeje mund të taten në Shtetin tjetër Kontraktues, Shteti Kontraktues i përmendur në fillim do të lejojë një reduktim nga tatimi mbi të ardhurat ose mbi kapitalin e atij rezidenti të një shume të barabartë me tatimin mbi të ardhurat ose mbi kapitalin e paguar në atë Shtet tjetër Kontraktues. Megjithatë, një reduktim i tillë nuk do të kalojë atë pjesë të tatimit mbi të ardhurat ose tatimit mbi kapitalin të llogaritur para dhënies së reduktimit, që i atribuohet sipas rastit të ardhurave ose kapitalit që mund të taten në atë Shtet tjetër Kontraktues.

2. Kur në përputhje me çdo dispozitë të kësaj Marrëveshjeje të ardhurat e realizuara ose kapitali i zotëruar nga një rezident i një Shteti Kontraktues përjashtohet nga tatimi në atë Shtet Kontraktues, megjithatë ky Shtet, në llogaritjen e shumës së tatimit mbi pjesën e mbetur të të ardhurave ose të kapitalit të këtij rezidenti, mund të marrë në konsideratë, të ardhurat ose kapitalin e përjashtuar.

#### Neni 24

##### **Mosdiskriminimi**

1. Nënshetasi e një Shteti Kontraktues nuk do të jenë, në Shtetin tjetër Kontraktues, subjekt i ndonjë tatimi ose kërkesë të lidhur me të, që të jetë i ndryshëm ose më i rëndë se sa tatimi dhe kërkesat e lidhura me të, të cilave i nënshtrohen ose mund t'i nënshtrohen nënshetasi e këtij Shteti tjetër Kontraktues në rrethana të njëjta.

2. Tatimi i një selie të përhershme që një sipërmarrje e një Shteti Kontraktues ka në Shtetin tjetër Kontraktues nuk do të jetë më pak i favorshëm në këtë Shtet tjetër Kontraktues sesa tatimi i ngarkuar ndaj sipërmarrjeve të këtij Shteti tjetër që ushtrojnë aktivitete të njëjta.

3. Përjashtuar rastet kur zbatohen dispozitat e paragrafit 1 të nenit 9, paragrafit 7 të nenit 11, ose paragrafit 6 të nenit 12, interesat, honoraret dhe shpërblime të tjera të paguara nga një sipërmarrje e një Shteti Kontraktues një rezidenti të Shtetit tjetër Kontraktues, për efekt të përcaktimit të fitimeve të tatueshme të kësaj sipërmarrje, do të jenë të reduktueshme nën të njëjtat kondita, njëllon sikur ato t'i paguheshin një rezidenti të Shtetit të përmendur në fillim. Në mënyrë të ngjashme, çdo borxh i një sipërmarrjeje të një Shteti Kontraktues ndaj një rezidenti të Shtetit tjetër Kontraktues, për efekt të përcaktimit të kapitalit të tatueshëm të kësaj sipërmarrje, do të jetë i reduktueshëm nën të njëjtat kondita, njëllon sikur ajo të kishte kontraktuar me një rezident të Shtetit të përmendur në fillim.

4. Sipërmarrjet e një Shteti Kontraktues, kapitali i të cilave është totalisht ose pjesërisht i zotëruar apo i kontrolluar, direkt ose indirekt nga një ose më shumë rezidentë të Shtetit tjetër Kontraktues, nuk do të jenë në Shtetin e përmendur në fillim subjekt i ndonjë tatimi ose kërkesë të lidhur me të, që të jetë i ndryshëm ose më i rëndë sesa tatimi ose kërkesat e lidhura me të, të cilave i nënshtrohen ose mund t'i nënshtrohen sipërmarrje të tjera të ngjashme të Shtetit të përmendur në fillim.

#### Neni 25

##### **Procedura e mirëkuptimit reciprok**

1. Kur një person mendon se veprimet e njërit apo e të dy Shteteve Kontraktuese e rëndojnë

apo do ta rëndojnë atë me tatime që nuk janë në përputhje me dispozitat e kësaj Marrëveshjeje, pavarësisht nga mënyrat e ankimit të parashikuara në legjislacionin e brendshëm të këtyre Shteteve, ai mund t'ia paraqesë rastin e tij autoriteteve kompetente të Shtetit Kontraktues rezident i të cilit ai është, ose nëse çështja e tij ka të bëjë me paragrafin 1 të Nenit 24, ai mund t'ia paraqesë atë Shtetit Kontraktues nënshtrë i të cilit ai është. Çështja duhet të paraqitet brenda tre vjetëve nga njoftimi i parë lidhur me veprimin që ka rezultuar në tatimin që nuk është në përputhje me dispozitat e Konventës.

2. Autoriteti kompetent, nëse kërkesa i duket e justifikuar dhe ai vetë nuk e ka të mundur arritjen e një zgjidhjeje të kënaqshme, do të përpiqet t'a zgjidhë çështjen me mirëkuptim reciprok me autoritetin kompetent të Shtetit tjetër Kontraktues, me synim shmangjen e tatimit që nuk është në përputhje me Marrëveshjen. Çdo marrëveshje e arritur do të zbatohet pavarësisht nga limitet kohorë të përcaktuar nga ligjet e brendshme të Shteteve Kontraktuese.

3. Autoritetet kompetente të Shteteve Kontraktuese do të përpiqen që me mirëkuptim reciprok të zgjidhin çdo vështirësi apo dyshim që lind nga interpretimi apo zbatimi i Marrëveshjes.

4. Autoritetet kompetente të Shteteve Kontraktuese mund të komunikojnë me njëri-tjetrin direkt, me qëllim arritjen e mirëkuptimit në kuptimin e paragrafëve të mësipërm të këtij neni.

Neni 26

### **Shkëmbimi i informacionit**

1. Autoritetet kompetente të Shteteve Kontraktuese do të shkëmbejnë informacionet e nevojshme për zbatimin e dispozitave të kësaj Marrëveshjeje ose të ligjeve të brendshme të Shteteve Kontraktuese lidhur me tatimet që mbulon Marrëveshja, përderisa ato tatime nuk janë në kundërshtim me Marrëveshjen, sidomos për parandalimin e mashtrimeve apo evazionit në këto tatime. Shkëmbimi i informacionit nuk kufizohet nga Nenet 1 dhe 2. Çdo informacion i marrë nga një Shtet Kontraktues do të trajtohet si sekret, në të njëjtën mënyrë si informacioni i marrë nën legjislacionin e brendshëm të atij. Megjithatë, nëse informacioni konsiderohet si sekret në Shtetin që e transmeton (jep) informacionin, ai do t'i serviret vetëm personave apo autoriteteve (përfshirë gjykatat dhe organet administrative) të përfshira në llogaritjen apo mbledhjen e tatimeve, me imponimin ose ndjekjet lidhur me shkeljet tatimore apo lidhur me ankesat ndaj tatimeve që mbulon Marrëveshja. Këto persona apo autoritete do ta përdorin informacionin vetëm për të tilla qëllime dhe mund ta servirin informacionin në procedurat apo vendimet gjyqësore.

2. Në asnjë rast, dispozitat e paragrafit 1 nuk do të interpretohen në kuptimin që i imponojnë njërit prej Shteteve Kontraktues detyrimin:

a) të zbatojë masa administrative në ndryshim me ligjet dhe praktikat administrative të atij Shteti apo të Shtetit tjetër Kontraktues;

b) të japë informacione që ndalohen sipas ligjeve apo praktikës normale administrative të atij Shteti apo të Shtetit tjetër Kontraktues;

c) të japë informacione që mund të nxirrin një sekret tregtar, biznesi, industrial apo profesional ose proces tregtar apo informacione, zbulimi i të cilave do të ishte në kundërshtim me rendin publik.

Neni 27

### **Funksionarët diplomatikë dhe konsullorë**

1. Dispozitat e kësaj Marrëveshjeje nuk cenojnë privilegjet fiskale të funksionarëve diplomatikë dhe konsullorë, që rrjedhin nga rregullat e përgjithshme të së drejtës ndërkombëtare apo nga dispozita të Marrëveshjeve të veçanta.

Neni 28

### **Hyrja në fuqi**

1. Kjo Konventë do të hyjë në fuqi me shkëmbimin e instrumenteve të ratifikimit dhe dispozitat e saj do të kenë efekt lidhur me të ardhurat e realizuara ose kapitalin e zotëruar më ose pas ditës së parë të janarit të vitit kalendarik që pason atë të hyrjes në fuqi të Konventës. Për qëllimet e nenit 27 (Shkëmbimi i informacionit), dispozitat e tij do të kenë efekt më dhe pas datës në të cilën

Konventa hyn në fuqi.

Neni 29  
**Përfundimi**

Kjo Konventë do të mbetet në fuqi deri në përfundimin nga njëri Shtet Kontraktues. Secili Shtet Kontraktues mund të përfundojë Konventën pas 5 vjetësh pas vitit të hyrjes në fuqi, duke dhënë njoftimin e përfundimit nëpërmjet kanaleve diplomatike, të paktën 6 muaj përpara përfundimit të çdo viti kalendarik. Në rast të tillë, Konventa do të pushojë së pasuri efekt lidhur me të ardhurat e realizuara ose kapitalin e zotëruar më ose pas ditës së parë të janarit që pason atë të dhënies së njoftimit të përfundimit.

Bërë në Tiranë, më 21 korrik, 2001, në dy kopjo në gjuhën shqipe, gjuhën e shtetit X dhe në gjuhën angleze, të tria tekstet me fuqi ligjore të barabartë, përveç në raste dyshimesh, në të cilat teksti në gjuhën angleze do të ketë përparësi.